



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 46/2020 (JR)  
Datë 19.10.2020

Vendim nr. 9 (JR)  
Datë 15.03.2023

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 15.03.2023, ditën e mërkurë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Nure Dreni, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 263, datë 17.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7, 8, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave e Lirive Themelore të Njeriut, (me Protokollet 1 e 12, të saj); Nenet 18, 29, 30, 31, 33/1, 41, 42 dhe 179/b, paragrafi “1”, “2” dhe “5” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Neni “F” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Nenet 47 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Nure Dreni (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë. Për shkak të funksionit, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, ajo iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, me shortin e hedhur nga Komisioni më datë 15.05.2018.
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).
3. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar<sup>1</sup> duke konstatuar se:
  - deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
  - ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
  - nuk ka kryer deklaram të rremë;
  - nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. DSIK-ja i dërgoi Komisionit raportin<sup>2</sup> mbi kontrollin e figurës duke konstatuar se nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar, si dhe përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Nure Dreni, në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

<sup>1</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 11.05.2018.

<sup>2</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 16.1.2020, të KDZh-së.

5. KLGj-ja ka hartuar Raportin<sup>3</sup> për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në: formularin e vetëdeklarimit dhe tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti; të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGj-së.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Me vendimin nr. 1, datë 22.11.2018, Komisioni vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe bazuar në pikën 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, më datë 13.11.2019, vendosi të përfundojë hetimin vetëm për kriterin e pasurisë. Pas kërkesës së subjektit të rivlerësimit, me vendimin e datës 10.12.2019, Komisioni vendosi: (i) të administrojë provat shkresore të paraqitura dhe të rihapë hetimin për kriterin e pasurisë; si dhe (ii) të çelë hetimin për kriterin e kontrollit të figurës dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

6.1. Pasi kreu hetim për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioni konstatoi se:

(i) *Për kriterin e vlerësimit të pasurisë*, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara, për katër vite, e konkretisht, 2011-2014, duke rezultuar me një balancë negative në total prej (-) 2.786.519 lekësh.

(ii) *Për kriterin e kontrollit të figurës*, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, Komisioni arriti me konkluzionin se znj. Nure Dreni ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

(iii) *Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*, bazuar në dokumentacionin e administruar, argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe në dispozitat ligjore të zbatueshme, Komisioni vlerësoi se gjetjet e konstatuara nuk janë të një peshe që të shërbejnë si provë për cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni konkludoi se për kriterin e aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues.

6.2. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, me vendimin nr. 263, datë 17.06.2020, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Nure Dreni, pasi nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera, për vitet 2011 – 2014. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të pikave 1 dhe 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>3</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 25.03.2019.

### III. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit Nure Dreni

7. Ankimi i subjektit të rivlerësimit mbështetet në dispozitat ligjore të referuara në hyrje të këtij vendimi. Me anën e tij, subjekti kërkon: (i) çeljen e hetimit gjyqësor; (ii) zhvillimin e gjykimit në seancë dëgjimore; (iii) përsëritjen e shqyrtimit të provave të dosjes së rivlerësimit; (iv) pranimin e provave të reja; si dhe (v) ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Argumentet e parashtruara prej saj në ankim përmbledhen në vijim.

7.1. Vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar, pasi provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk u jepet fuqi provuese, bazuar në përmbajtjen dhe vërtetësinë e tyre, sipas saj, pavarësisht dorëzimit të provave të mjaftueshme në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet, ato nuk janë marrë parasysh.

7.2. Në marrjen e vendimit, Komisioni ka kryer shkelje procedurale dhe materiale, të cilat vijnë në kundërshtim të hapur me Kushtetutën dhe ligjin nr. 84/2016, pasi pas riçeljes së hetimit për kriterin e pasurisë dhe për dy kriteret e tjera, nuk është njohur me rezultatin apo analizën e gjetjeve të Komisionit. Kjo mënyrë e zhvillimit të procedurës së gjykimit administrativ ka cenuar rëndë të drejtën e saj për një proces të rregullt ligjor.

7.3. Mënyra e zhvillimit të procesit nga Komisionit ka parregullsi, pasi: (i) i është dërguar pyetësori nr. 2 përpara se t'i dërgohej pyetësori nr. 1 dhe, me këtë të fundit, është njohur vetëm pas kërkesës së saj të shprehur; (ii) procesi është zvarritur mbi dy vjet; (iii) vendimi i Komisionit përmban informacion të ri, që do të thotë që Komisioni ka bërë rihetim pas raportit të dytë dhe ribërë analizë financiare, me të cilën subjekti nuk është njohur. Këto veprime përbëjnë shkelje të rëndë procedurale dhe cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, që garanton të drejtat e palës dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, duke u gjendur përpara një trupe gjyqëse subjektive, paragjyqëse dhe të njëanshme.

7.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61/3 të ligjit nr. 84/2016, pasi ky parashikim kërkon në mënyrë kumulative plotësimin e dy kushteve: deklarimin e pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë. Penalizimi i saj me masën ekstreme të shkarkimit nga detyra është në tejkalim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, pasi dukshëm nuk rezulton të ketë pasuri më shumë se dyfishi i të ardhurave.

7.5. Edhe nëse kushtet e parashikuara në nenin 61/3 të ligjit nr. 84/2016 nuk do të ishin kumulative, vlerësimi i Komisionit nuk e përlij masën e shkarkimit nga detyra, pasi sjellja e subjektit, në kuadër të deklarimit të pamjaftueshëm, duhet të jetë e tillë që të ketë të njëjtin nivel kundërligjshmërie, sikurse janë shkeljet e renditura në pikat 1, 2, 4 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

7.6. Në respekt të një procesi të rregullt ligjor, subjekti i rivlerësimit, kërkon që të administrohen dhe të pranohen për shqyrtim disa prova të reja për të mbështetur shkaqet e ankimit mbi rillogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe për sa i përket deklarimit të likuiditeteve (gjendjes *cash*).

## *Shkaqet ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë*

7.7. Subjekti i rivlerësimit ka detajuar pretendimet e saj mbi analizën financiare të kryer nga Komisioni për secilin vit, duke dhënë argumentet e saj për atë që ajo e cilëson ndreqjen/“korigjimin” e vlerave në zëra specifikë. Në përfundim, pasi ka argumentuar për balanca pozitive, subjekti ka parashtruar se të ardhurat e realizuara nga ajo dhe familjarët e saj mbulojnë të gjitha shpenzimet familjare. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur provat që mbështesin pretendimet e saj, të cilat, sipas saj, janë pasqyruar edhe në aktin e ekspertimit të datës 20.11.2019 të shoqërisë audituese “{\*\*\*}”.

7.8. Subjekti argumenton se konkluzioni i Komisionit, për deklaram të pasaktë të burimit të krijimit të pasurisë së luajtshme [automjet “Citroen C3”] në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi pagesa e kryer *cash* në shumën 6.900 euro, në muajin shkurt, është zëvendësuar menjëherë nga fondet e fituara nga ekzekutimi i vendimit të gjykatës, ekzekutuar nga zyra e përmbarimit më datë 14.05.2010. Sipas subjekti, gjendja *cash* në këtë vit është e pandryshuar. Për këtë arsye, ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* se burim i të ardhurave për blerjen e këtij automjeti është edhe nga të ardhurat e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

7.9. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se ajo dhe personat e lidhur kanë *pamjaftueshmëri* financiare për vitin 2011, për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzimet e tjera familjare, duke rezultuar me bilanc negativ në vlerën 393.759 lekë. Sipas saj duhet të analizohen me saktësi dhe në detaj faktorët e shpenzimeve, të merren në konsideratë dietat e shërbimeve të kryera nga bashkëshorti i saj, z. S. D., duke reduktuar shpenzimet vjetore jetike dhe të zbritet mbivendosja e shpenzimeve të jetesës.

7.10. Subjekti i rivlerësimit kundërshton mënyrën e përlogaritjes së shpenzimeve të udhëtimit e qëndrimit të tre fëmijëve të saj nga Komisioni. Sipas saj, shpenzimet në vendimin përfundimtar arrijnë një vlerë më të lartë sa ishin llogaritur në analizën financiare të rezultatit të hetimit. Subjekti, po ashtu, kundërshton analizën financiare të Komisionit, për sa i përket shpenzimeve të shkollimit të vajzave të saj.

7.11. Subjekti i rivlerësimit e konsideron të padrejtë konkluzionin e Komisionit në pikën 31.20 të vendimit të tij, sipas të cilit ajo dhe personat e lidhur kanë pasur *pamjaftueshmëri* financiare për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzimet e tjera familjare në vitin 2012, duke rezultuar me një bilanc negativ në vlerën 674.543 lekë. Me të njëjtat argumente si për analizën financiare të vitit 2011, subjekti kërkon përfshirjen e të ardhurave nga dietat e bashkëshortit të saj, rillogaritjen e shpenzimeve jetike, shpenzimeve të udhëtimit dhe shkollimit të vajzave të saj, si dhe marrjen në konsideratë të dokumentacionit provues për udhëtimin familjar me paketë turistike, në Palma de Majorca (Spanjë).

7.12. Lidhur me analizën financiare për vitin 2013, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar/mbuluar shpenzimet në vitin kalendarik 2013, pasi balanca negative për vitin 2013, në vlerën 300.309 lekë ka ardhur si pasojë e mospërfshirjes në analizën financiare të bërë nga Komisioni të vlerës së saktë të pakësimit të gjendjes *cash*, e deklaruar nga subjekti ndër vite, pakësim ky i pasqyruar saktë në

deklaratën e interesave periodike të vitit 2013, si dhe janë rillogaritur gabim/mbivendosje kostot e shpenzimeve të jetesës dhe ato të udhëtimeve.

7.13. Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën financiare për vitin 2014, për të cilën, sipas Komisionit, ka rezultuar me një bilanc negativ në vlerën (-) 1.417.908 lekë. Duke ripërsëritur qëndrimet e saj lidhur me llogaritjen e shpenzimeve jetike për ditët e qëndrimit të bashkëshortit të saj jashtë vendbanimit, llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit dhe shkollimit të vajzave të saj.

7.14. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për pamundësi financiare për të pakësuar gjendjen cash në vlerën 1.600.000 lekë, në vitin 2014, duke argumentuar se në datën 31.12.2013 ka disponuar cash vetëm vlerën prej 44.175 lekësh. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 ka deklaruar shumën 1.900.000 lekë të investuar në bono thesari në Bankën e Shqipërisë. Kjo shumë është tërhequr në fund të muajit tetor të vitit 2004 dhe është mbajtur cash në banesë e është pakësuar në vitet e mëvonshme, sipas deklaratave periodike të pasurisë.

7.15. Në mbështetje të pretendimeve të saj, subjekti i rivlerësimit paraqet si argument qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në vendimet e tij mbi deklarin e likuiditeteve<sup>4</sup> dhe në lidhje me pasaktësitë në deklarinet periodike të pasurisë<sup>5</sup>, duke kërkuar që të merret në konsideratë dhe mosdeklarin i veprimit (tërheqje në bankë dhe kalim në cash), në DPV-në e vitit 2004. Sipas subjektit, ky veprim duhet të vlerësohet si një pakujdesi/gabim në plotësimin e deklaratës dhe jo si shkak që prodhon situatën e deklarin të pamjaftueshëm dhe pamjaftueshmëri financiare.

8. Në kërkimin përfundimtar, subjekti kërkon kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes dhe ndryshimin e vendimit nr. 263, datë 17.06.2020, të Komisionit dhe konfirmimin e saj në detyrë, bazuar në nenet 63, pika 1, 65, 66 pika 1, germa “b” dhe nenin 58, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenet 47, 51, pika 1, gjerat “a”, ”b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012 “Për

---

<sup>4</sup> Subjekti i rivlerësimit referon në vendimin e Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit Tom Ndreca [nr. 11/2018 (JR), datë 22.11.2018], në të cilin, ndër të tjera, arsyetohet se: “Trupi gjykues vlerëson [...] se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur në raport me deklarin e këtyre likuiditeteve përgjithësisht një qëndrim jo korrekt, për sa kohë që nuk e kanë deklaruar këtë gjendje në deklarata të ndryshme periodike, por mungesa e këtyre deklarinave nuk është e shoqëruar me ndonjë sjellje të subjektit për të fshehur të ardhurat dhe, për më tepër, rezulton e provuar nga hetimi administrativ se burimi i krijimit të këtyre pasurive është i ligjshëm dhe vjen nga puna e personave të lidhur. Gjithashtu, gjendja e këtyre pasurive është lehtësisht e verifikueshme dhe e kontrollueshme, për sa kohë që janë llogari brenda sistemit bankar. Mosdeklarin i tyre [...] duket se ka qenë një qasje e pakujdeshme e subjektit [...] në drejtim të plotësimit me përpikërinë e duhur të deklarinave periodike të pasurisë, por që pavarësisht nuk përmbajnë elemente që do i konsideronin këto pasaktësi të mjaftueshme si shkak autonom shkarkimi [...], por që janë konsideruar nga trupi gjykues në kuptim të vlerësimit tërësor të kriterit të pasurisë”.

<sup>5</sup> Subjekti i rivlerësimit referon në vendimin e Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit Adriatik Cama [nr. 05/2019 (JR), datë 18.02.2019], në të cilin, ndër të tjera, citohet se: “Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se sipas ligjit nr. 84/2016, pamjaftueshmëria e deklarin për deklarinet e mëparshme periodike të pasurisë, nëse subjekti ka bërë deklarin të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklarin të rremë, në vitet përkatëse, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklarin të pamjaftueshëm [...] për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element, i cili konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit”.

organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

##### A. Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjyimit

##### i) Juridiksioni i Kolegjit dhe legjitimimi i ankuesit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Nure Dreni, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>6</sup> nga data e njoftimit të vendimit të këtij të fundit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

##### ii) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 263, datë 17.06.2020, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
11. Sa u takon akteve shkresore, që subjekti i ka bashkëlidhur ankimit të saj, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012<sup>7</sup>, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti

<sup>6</sup> Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi objekt shqyrtimi i Komisionit i është njoftuar subjektit të rivlerësimit më datë 22.09.2020. Marrja dijeni nga subjekti i rivlerësimit është konfirmuar sipas lajmërim-marrjes së shërbimit postar. Ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision në datën 06.10.2020, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar ankimin e saj në Komision brenda afatit ligjor për të ushtruar ankim, nën dritën e nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

<sup>7</sup> Neni 47 i ligjit nr. 49/2012, parashikon që: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues, mbi kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016<sup>8</sup>.

12. Në kuadër të sa më sipër, lidhur me aktet<sup>9</sup> e paraqitura nga subjekti me ankimin, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:

i) deklaratat noteriale të hartuara në vitin 2020, nëpërmjet të cilave subjekti kërkon të justifikojë mbulimin e shpenzimeve të kryera prej saj dhe personave të lidhur, nuk janë të pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, por ato nuk mund të kenë fuqi provuese në këtë proces, pasi rezultojnë të jenë hartuar gjatë procesit të rivlerësimit dhe, për këtë shkak dhe nga përmbajtja, krijojnë bindjen se janë konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit;

ii) korrespondenca nëpërmjet postës elektronike mes personit të lidhur me subjektin [vajza] me {\*\*\*} [{\*\*\*}], po ashtu, iniciuar pas marrjes së vendimit të Komisionit, jo vetëm që nuk provon mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit nga shoqata në fjalë, por në kushtet kur daton disa muaj pas shpalljes së vendimit të Komisionit, që vendosi shkarkimin e subjektit, dështon të provojë pamundësinë objektive të marrjes së dokumenteve, parashikuar nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016<sup>10</sup>;

iii) deklaratat e interesave periodike privatë të vitit 2013 dhe 2014, të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ndodhen të administruara në fashikujt e Komisionit.

12.1. Subjekti i rivlerësimit potencon se është njohur me ndryshimet që ka pësuar zëri “shpenzime udhëtimi” vetëm në vendimin e Komisionit, në dallim me vlerën që i është përcjellë në analizën financiare me rezultatet e hetimit administrativ për këtë zë. Trupi gjykues vëren që në vendimin përfundimtar, Komisioni ka reduktuar në një raport të konsiderueshëm balancën negative të mungesës së burimeve të ligjshme. Konkretisht, nga (-) 5.238.103 lekë të konstatuar në rezultatet e hetimit administrativ, vlera përfundimtare e konstatuar nga

<sup>8</sup> “[...] Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; c) mjeti i provës është tërësisht i papërshtatshëm ose i paarrtshëm; ç) bëhet me qëllim zvarritjen e gjykimit; d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit [...]”.

<sup>9</sup> Subjekti ka paraqitur bashkë me ankimin tetë (8) akte, e konkretisht: (i) katër (4) deklaratat noteriale të hartuara pas vendimit objekt ankimi. Tre prej tyre kanë për qëllim të zbresin shpenzime udhëtimeve të caktuara jashtë Shqipërisë, të cilat i janë përlllogaritur subjektit në shpenzimet e viteve përkatëse, ndërsa e katërta [deklaratë noteriale], nga një përfaqësuese e një agjencie udhëtimi referon se shpenzimet në Spanjë [Palma de Majorca] janë kryer sipas çmimit të faturës tatimore dhe kuponit tatimor datë 01.08.2012; (ii) një (1) ekstrakt historik për agjencinë e udhëtimit, e cila ka ndërmjetësuar njërin prej udhëtimeve familjare; (iii) dy (2) deklaratat periodike vjetore të bashkëshortit si subjekt deklaruar, sipas ligjit nr. 9049/2003 [për vitet 2013 dhe 2014]; dhe (iv) një kopje e shtypur e një korrespondence nëpërmjet postës elektronike mes së bijës dhe {\*\*\*} [{\*\*\*}].

<sup>10</sup> “[2.] Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merrret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor [...]”.



Komisioni është (-) 2.786.519 lekë. Nga ana tjetër, shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur me një vlerë pak më të lartë në vendim krahasuar me rezultatet e hetimit. Në kushtet kur balanca negative përfundimtare është 53% më e ulët sesa ajo me të cilën subjekti ishte njohur gjatë hetimit, edhe nëse abstragohet nga fakti që aktet e sjella nuk përmbushin kriteret e përcaktuara nga ligji për provat e reja në ankim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se mënyra e përlllogaritjes së shpenzimeve të udhëtimit në vendimin përfundimtar të Komisionit nuk shoqërohet me një peshë që do të bënte vendimin të cenueshëm në tërësinë e tij, sikurse edhe janë të një peshe financiare që nuk ndikon në zgjidhjen përfundimtare, siç arsyetohet në vijim të këtij vendimi.

12.2. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues çmon se aktet e reja të sjella nga subjekti me ankimin duhet të refuzohen nën dritën e dispozitave të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk lejohen nga ligji – arsyetuar më sipër nën dritën e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 – si dhe për shkak se janë të panevojshme për vendimmarrjen apo lidhen me fakte që, edhe nëse pranohen të mirëqena, janë pa rëndësi në zgjidhjen e çështjes, parashikuar nga germa “b” dhe “d”, pika 6 e nenit 49 të ligjit nr. 84/2016<sup>11</sup>. Për këto arsye, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të shqyrtojë ankimin mbi bazë aktesh, pasi nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve, nën dritën e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

*B) Vlerësimi lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor*

13. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar, pasi provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet, nuk u jepet fuqi provuese. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se ky pretendim është i pabazuar. Vendimi objekt shqyrtimi i Komisionit përmban analizën e akteve të paraqitura nga subjekti përgjatë hetimit administrativ. Rezulton se Komisioni ia ka nënshtruar vlerësimit të tij provat, duke marrë qëndrim mbi vlerën provuese të akteve të sjella prej subjektit të rivlerësimit. Këto akte janë çmuar përkundër ndikimit që ato kanë mbi çështjet e ngritura, në zbatim të parimit të parashikuar nga neni 81 i Kodit të Procedurave Administrative<sup>12</sup>. Për sa i përket pretendimeve të subjektit, në lidhje me aktet e depozituar në Komision në cilësinë e provës, në referencë edhe të jurisprudencës së Kolegjit<sup>13</sup>, trupi gjykues çmon se fakti që këto akte e prova të subjektit Komisioni nuk i ka vlerësuar në mënyrën e dëshiruar prej saj nuk passjell logjikisht se ka munguar vlerësimi lidhur me to. Ky është edhe interpretimi i vlerësimit të provave zhvilluar nga jurisprudenca e GjEDNj-së, në drejtim të zbatimit në praktikë të garancive të procesit të rregullt ligjor, në çështjen *Wierzbicki k. Polonisë, 2002*<sup>14</sup>.

<sup>11</sup> Referuar në poshtëshënimin nr. 8 më sipër.

<sup>12</sup> “[...] Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatit tërësor të hetimit administrative”.

<sup>13</sup> Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit në çështjet që i përkasin subjekteve të rivlerësimit I. Kadana (JR 3/2020), paragrafi 25, A. Çela, paragrafi 13, (JR nr. 6/2020), I. Mulkurti paragrafi 19.1 (JR nr. 8/2021) dhe E. Beçi, paragrafi 11 (JR nr.4/2021).

<sup>14</sup> Neni 6 i Konventës nuk garanton në mënyrë eksplicite të drejtën për të thirrur dëshmitarë apo për të paraqitur prova të tjera në gjykimet civile. Në lidhje me këtë, gjykata përsërit se vlerësimi i rëndësisë së provave për çështjet konkrete është kompetencë e gjykatave të brendshme.

13.1. Në këtë kontekst, trupi gjykues risjell në vëmendje jurisprudencën e tij të mëparshme<sup>15</sup>, në të njëjtën linjë me jurisprudencën e GjEDNj-së, ku është arsyetuar se:

*“[19.1] Nga analiza e akteve në fashikull, përkundër pretendimeve të subjektit për provat, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vlerësimi i provave nuk rezulton të jetë pasojë e mosadministrimit apo e mosmarrjes së tyre në konsideratë, por rrjedhojë e vlerës provuese të tyre në raport me kërkesat ligjore. Kjo qasje e Komisionit është në përputhje me ligjin nr. 84/2016, i cili përcakton diskrecionin e Komisionit [dhe Kolegjit] [...] të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes<sup>16</sup> [...] dhe që ta bazojnë vendimin e tyre [...] vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera [...]”<sup>17</sup>. Ky diskrecion ligjor, në vlerësimin e provave, i gjykatave – e në rastin konkret edhe i një organi administrativ si Komisioni – është në përputhje të plotë edhe me jurisprudencën e GjEDNj-së. Konkretisht, në García Ruiz kundër Spanjës, gjykata ka konkluduar se pranueshmëria dhe vlerësimi i provave mbi themelin në përgjithësi janë kompetencë vetëm e gjykatave kombëtare, të cilat duhet të peshojnë elementet e mbledhura prej tyre dhe se pranueshmëria e provave dhe vlerësimi i tyre në parim janë kompetencë e së drejtës së brendshme dhe gjykatave kombëtare<sup>18</sup>. Nën dritën e këtij përcaktimi ligjor, përkundër pretendimeve të subjektit në ankim, të cilat kufizohen në aludimet e përgjithshme sa më sipër, e që në thelb nuk përmbajnë analizë të inkonsistencës mes çfarë është administruar me dokumentacion dhe asaj çfarë është konkluduar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, ky pretendim i subjektit rezulton i pabazuar [...]”.*

13.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje, trupi gjykues konstaton se Komisioni, më datë 10.12.2019, ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për paraqitjen e provave të reja, parashtruar në datën 01.12.2019. Për sa i përket kërkesës së subjektit në Kolegj, për rivlerësimin e provave të administruara nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se ky hap përbën pjesë të qenësishme të procedurës së shqyrtimit të shkaqeve të ankimit dhe, si i tillë, kryhet nga Kolegji edhe gjatë vendimmarrjes mbi bazë aktesh. Me fjalë të tjera, analiza e provave nuk mund të argumentohet se kushtëzohet nga zhvillimi i debatit gjyqësor me praninë e subjektit. Për rrjedhojë, kjo kërkesë e subjektit konsiderohet e ezauruar nëpërmjet shqyrtimit gjyqësor dhe kontrollit të vendimit të Komisionit mbi bazën e shkaqeve të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit dhe është pjesë integrale e këtij arsyetimi.

14. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka kryer *shkelje procedurale dhe materiale*, në kundërshtim të hapur me Kushtetutën dhe ligjin nr. 84/2016, pasi pas riçeljes së hetimit për kriterin e pasurisë, si dhe për dy kriteret e tjera [ajo] nuk është njohur me rezultatin e gjetjeve të Komisionit. Si pasojë, pretendon subjekti i rivlerësimit, në seancën dëgjimore nuk ka qenë

<sup>15</sup> Vendimi i Kolegjit për ankimin e subjektit të rivlerësimit I. Mulkurti (JR nr. 8/2021), paragrafi 19.1.

<sup>16</sup> Neni 49, pika 4, fjalia e dytë e ligjit nr. 84/2016.

<sup>17</sup> Si më sipër, fjalia e parë e së njëjtës dispozitë.

<sup>18</sup> Shih udhëzuesin mbi nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – E drejta për një proces të rregullt (aspekti civil) - [https://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_SQI.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_SQI.pdf) [GC], § 28).

në gjendje të realizojë një mbrojtje efektive, pasi nuk ka qenë në dijeni të faktit nëse në gjetjet e evidentuara në raportin e parë ishin reflektuar provat e paraqitura prej saj. Sipas subjektit, kjo mënyrë e zhvillimit të procedurës së gjykimit administrativ ka cenuar rëndë të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

**14.1.** Nga analiza e dokumentacionit të ndodhur në fashikujt e përcjellë nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Nga aktet rezultojnë që Komisioni i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit raportin e hetimit administrativ vetëm për kriterin e pasurisë dhe i ka kaluar barrën e provës mbi bazën e gjetjeve të konstatuara, nëpërmjet e-mail-it të datës 14.11.2019. Më datë 01.12.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegimet për vlerësimin e pasurisë dhe njëkohësisht ka paraqitur kërkesën për marrjen e provave të reja, si dhe riçeljen e hetimit administrativ dhe për dy kriteret e tjera të vlerësimit të figurës dhe vlerësimin profesional. Më datë 10.12.2019, pasi vendosi të pranojë provat e reja të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe, për pasojë, edhe riçeljen e hetimit për kriterin e pasurisë, Komisioni ka çelur hetimin edhe për dy kriteret e tjera mbi bazën e kërkesës së subjektit. Me e-mail-in e datës 07.02.2020, Komisioni i përcolli subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit administrativ shtesë. Pas këtij hetimi, në pjesën e kriterit të pasurisë, Komisioni ka konstatuar vetëm një gjetje<sup>19</sup>, për të cilën i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës. Më datë 18.02.2020, subjekti ka sjellë shpjegimet e saj në lidhje me këtë rezultat të hetimit administrativ.

**14.2.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se është i pasaktë edhe pretendimi i subjektit se provat dhe gjetjet e saj nuk janë marrë në konsideratë, sikurse shtjellohet edhe më sipër. Nga analizimi i vendimit,<sup>20</sup> rezultojnë se Komisioni i ka konsideruar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bindëse dhe, për rrjedhojë, ka reduktuar në një raport të konsiderueshëm balancën negative, nga (-) 5.238.103 lekë të konstatuar në rezultatet e hetimit administrativ, në vlerën përfundimtare (-) 2.786.519 lekë. Nga shqyrtimi i akteve, rezultojnë që Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të justifikuar vlerën negative prej (-) 5.238.103 lekësh (shprehur në faqen 34 të rezultateve të hetimit administrativ). Në faqet 30 – 32 të rezultateve të hetimit administrativ, pasqyrohen me detaje në formë narrative dhe tabelare vlerat dhe balancat financiare për secilin vit për periudhën 2011 – 2014, sipas përlllogaritjeve paraprake të Komisionit. Vetë subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e rezultateve, ka dhënë shpjegime të hollësishme për çdo vit, duke kërkuar përkatësisht edhe ndryshimin e vlerave konkrete. Nën dritën e këtyre fakteve, trupi gjykues vlerëson se mospërputhja mes shifrave nuk mund të zhbëjë faktin që subjekti i rivlerësimit ka qenë i mirëinformuar gjatë gjithë hetimit administrativ dhe i është dhënë mundësia të mbrohet plotësisht mbi këtë komponent të vlerësimit të pasurisë. Për rrjedhojë, subjektit i është garantuar zbatimi në praktikë i garancive për një proces të rregullt, të bazuar në parimin e kontradiktorialitetit dhe barazisë së armëve.

## 15. *Pretendimet për parregullsi në mënyrën e zhvillimit të procesit nga ana e Komisionit*

<sup>19</sup> Komisioni ka konstatuar një parregullsi të kontratës së porosisë së lidhur mes personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe znj. D. D. (kunata), më datë 29.12.2001 [nr. {\*\*\*} kol., dhe nr. {\*\*\*} rep.]. Nëpërmjet kësaj kontrate, personi i lidhur/z. D., është autorizuar të investonte për llogari të znj. D. D. shumën prej 3.000.000 lekësh në bono thesari në Bankën e Shqipërisë. Ky veprim referohet të jetë kryer gjatë viteve 2002 – 2003.

<sup>20</sup> Faqe 20 e vendimit të Komisionit.

15.1. Subjekti potencon parregullsi në mënyrën sesi Komisioni e ka ndërtuar procesin, pasi: (i) i ka drejtuar pyetësorët pa radhën e natyrshme [pyetësorin nr. 2 përpara atij nr. 1]; (ii) procesi është *zvarritur* dy vjet; (iii) vendimi i Komisionit përmban informacion të ri, që, sipas subjektit, nënkupton që Komisioni ka kryer rihetim pas raportit të dytë dhe analizë financiare të re me të cilën subjekti nuk është njohur. Nën dritën e sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka kryer shkelje të rënda procedurale dhe ka cenuar të drejtën e saj për një proces të rregullt ligjor. Sipas subjektit, paragjykimi i trupit gjykues [të Komisionit] është materializuar në pyetjet *tendencioze* në çdo pyetësor gjatë gjithë procesit të hetimit administrativ.

15.2. Pas analizimit të akteve në fashikull dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni rezulton t'i ketë dërguar subjektit të rivlerësimit pyetësorin nr. 2 përpara atij me nr. 1. Pretendimi i subjektit për këtë aspekt është i bazuar. Pas kërkesës së subjektit, dërguar nëpërmjet *e-mail*-it të datës 04.02.2019, asaj i është dërguar pyetësori me nr. 1, në të njëjtën ditë. Përgjigjet e këtij pyetësori janë dhënë nga subjekti i rivlerësimit më datë 20.02.2019. Pavarësisht nga ky fakt i konfirmuar, trupi gjykues çmon se dërgimi i pyetësorëve jo sipas numrit rendor kronologjik, dhe në kushtet kur kjo parregullsi është korrigjuar dhe ka vijuar me procesin standard të pyetjeve dhe përgjigjeve të pyetësorëve të radhës, nuk përbën një mangësi, e cila mund të argumentohet se përbën cenim të procesit të rregullt ligjor për subjektin e rivlerësimit.

15.3. Për sa i përket pretendimeve që lidhen me *kohëzgjatjen* e procesit të hetimit administrativ, nga shqyrtimi i akteve të çështjes, trupi gjykues konstaton se ato janë, po ashtu të pabazuara. Së pari, nga aktet rezulton se harku kohor i hetimit administrativ për subjektin ka përfshirë periudhën nga nëntori 2018 deri në qershor 2020 – me vendimin përfundimtar shpallur më 17.06.2020. Në total, nga përlllogaritja janë përreth 19 muaj dhe jo dy (2) vjet, siç referon subjekti. Gjatë kësaj periudhe kohore, rezulton, po ashtu nga fashikulli, se Komisioni fillimisht ka përfunduar hetimin vetëm për kriterin e pasurisë më 13.11.2019 ose një (1) vit pas nisjes. Pavarësisht nga ky fakt, pasi ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka çelur hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, më datë 10.12.2019. Ky hetim ka përfunduar më datë 07.02.2020. Nga këto të dhëna rezulton që Komisioni ka zhvilluar procesin e mbledhjes së dokumentacionit dhe analizës për rreth 12 muaj dhe e ka zgjatur hetimin edhe (3) tre muaj të tjerë si pasojë e kërkesës së subjektit, deri në shkurt 2020. Gjatë kësaj periudhe, ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit ka pasur shkëmbime të vazhdueshme korrespondence.

15.4. Si rrjedhojë e këtyre ndërveprimeve, subjekti ka dhënë sqarime dhe informacion, ka përcjellë dokumentacion provues në përgjigje të 5 (pesë) pyetësorëve, pyetjeve shtesë, është njohur me dokumentacionin e administruar nga Komisioni dhe ka dhënë shpjegime në përgjigje të barrës së provës, të përcjellë me rezultatet e hetimit administrativ dhe të finalizuar me dëgjimin e shpjegimeve në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 03.03.2020. Në periudhën e ndërmjetme, nga marsi 2020 deri në qershor 2020, në zbatim të Aktit Normativ të Këshillit

të Ministrave me nr. 3, datë 15.03.2020<sup>21</sup>, për shkak të gjendjes së pandemisë globale, Komisioni sikurse edhe institucionet e tjera nuk kanë zhvilluar seanca publike.

15.5. Nga këto fakte rezulton qartë që pretendimi i subjektit për *zvarritje* është tërësisht i pabazuar. Procesi në Komision, në tërësi për të, ka zgjatur 19 muaj, periudhë në të cilën përfshihet zgjatja e kohës, për shkak të pranimit të kërkesës së vetë subjektit dhe afro tre muajve të pezullimit të veprimtarisë, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme të pandemisë. Në kushtet kur hetimi i Komisionit fillimisht ka përfunduar në nëntor 2019, rezulton që qasja e ndjekur nga Komisioni, pavarësisht alternativës që parashikon ligji për të kryer procesin e rivlerësimit dhe marrë vendim edhe vetëm për një kriter<sup>22</sup>, paraqitet favorizuese ndaj subjektit të rivlerësimit, dhe brenda afateve normale të zhvillimit të hetimit administrativ, krahasuar me kohëzgjatjet e proceseve të zhvilluara në Komision për subjekte të tjerë të rivlerësimit. Po ashtu, në kushtet kur një pjesë e zgjatjes ka qenë si rrjedhojë e pranimit të kërkesës së subjektit, e bën pretendimin e saj për *zvarritje* të procesit të pakuptimtë.

15.6. Pretendimi tjetër i subjektit se vendimi i Komisionit përmban *informacion të ri*, që sipas saj dëshmon që Komisioni ka bërë *rihetim* pas raportit të dytë dhe *analizë të re financiare*, me të cilën subjekti nuk është njohur, është po ashtu i pabazuar në aktet në fashikull. Sikurse është trajtuar edhe më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti është njohur me rezultatet e të dy hetimeve të kryera nga Komisioni, ka marrë kopje dokumentacioni fizik dhe në formë elektronike (CD) të dosjes së hetimit administrativ, çka dokumentohet me deklaratën<sup>23</sup> e subjektit të datë 14.11.2019 dhe datës 10.02.2020, si dhe ka paraqitur shpjegime dhe prova në mbështetje të argumenteve të saj. Analiza financiare e Komisionit, e hartuar në përfundim të hetimit administrativ, është bazuar në të dhënat e derivuara nga aktet e administruara. Subjekti i rivlerësimit është njohur me të e ka parashtruar kundërgargumentet e saj. Në këto kushte, edhe ky pretendim rezulton i pabazuar.

15.7. Nga një analizë e vendimit objekt shqyrtimi krahasuar me rezultatet e hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se në pikat 30.24, 31.19, 32.20 dhe 33.21, të cilat i përkasin respektivisht analizës financiare për vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014, Komisioni ka marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe ka zbritur shpenzimet e jetesës përkundër atyre të pasqyruara në tabelën e rezultateve të hetimit administrativ, ndërsa nga ana tjetër ka rritur vlerën në zërin *shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së*, si dhe zërin *shpenzime udhëtimi*. Po ashtu, nga krahasimi mes dy tabelave financiare në fjalë, rezulton se në analizën përcjellë subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni është referuar fillimisht në çmimet e biletave, sipas metodologjisë të përcaktuar nga Kolegji, të cilat përbëjnë ndryshime thuajse në vlera të papërfillshme krahasuar me çmimet e referuara në dokumentacionin e përcjellë nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve. Ky zë shpenzimesh ka pësuar ndryshim në vendim, ku Komisioni ka pasqyruar vlerat, sipas dokumentacionit të

---

<sup>21</sup> Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. Shih Fletoren Zyrtare nr. 37 të vitit 2020.

<sup>22</sup> Sipas nenit 4, pika 2, i cili parashikon që në diskrecion të organeve të rivlerësimit: “[...] Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave [...]”.

<sup>23</sup> Në këtë akt në nënshkruar prej saj, subjekti shprehet me shkrim: “Deklaroj se nuk kam asnjë vërejtje në lidhje me dokumentacionin/materialet e tërhequra pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.

përcjellë nga subjekti i rivlerësimit me *e-mail*-in e datës 12.03.2019, duke përcaktuar shpenzimet e udhëtimit mbi çmimet e biletave të dorëzuara prej vetë subjektit. Në kushtet kur analiza i nënshtrohet shqyrtimit dhe prapësimeve, sipas rastit, nga ana e subjektit, ajo nuk mund të përbëjë një akt përfundimtar. Akti përfundimtar i procesit mbetet vendimi i dhënë, sipas përcaktimeve të nenit 58, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht nga ky fakt, pretendimi i subjektit në thelb paraqitet i pakuptimtë në kushtet kur reflektimet e shpenzimeve janë pasojë e prapësimeve të saj dhe në të paktën njërin zë janë referuar e kërkuar prej asaj vetë. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues konstaton që edhe ky pretendim i subjektit është i papabazuar. Ndonëse vendimi i Komisionit përmban vlera të ndryshme për disa zëra krahasuar me rezultatet e hetimit administrativ, pavarësisht prej disa zgjedhjeve të gabuara të vlerave nga Komisioni, në kushtet kur balanca negative totale mes të ardhurave me burime të ligjshme dhe shpenzimeve është reduktuar ndjeshëm në vendimin objekt shqyrtimi, trupi gjykues i Kolegjit nuk konstaton cenim të parimeve të procesit të rregullt.

**15.8.** Subjekti i rivlerësimit pretendon, po ashtu, se veprimet e sipëranalizuara të Komisionit përbëjnë shkelje të rënda procedurale dhe cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor që garanton të drejtat e saj në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit. Subjekti pretendon që trupi gjykues ka qenë paragjykues, gjë që dëshmohet në pyetjet *tendencioze* në çdo pyetësor gjatë gjithë procesit të hetimit administrativ. Trupi gjykues i Kolegjit vëren që edhe në këtë këndvështrim pretendimet e subjektit rezultojnë të papabazuara në akte dhe në ligj, përpos të pakuptimta. Në kushtet kur subjekti pretendon tendenciozitet, por ka dështuar të ilustrojë se cila prej pyetjeve përbën paragjykim apo mbi çfarë baze ka ndodhur mungesa e paanësisë, analiza e ndërveprimeve mes Komisionit dhe subjektit u krye në nivelin parimor. Nga dokumentacioni në fashikujt e Komisionit, rezulton që pyetësorët e dërguar subjektit të rivlerësimit paraqesin pyetje në funksion të procesit të saj të rivlerësimit. Pyetjet janë pjesërisht standarde e pjesërisht të përshtatura nevojës së hetimit për rrethanat faktike të rastit. Komisioni ka kërkuar sqarime dhe dokumentacion justifikues mbi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite, provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, provat shkrese të administruara në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, nga institucionet qendrore shtetërore, bankat e nivelit të dytë, zyrat vendore dhe drejtoritë rajonale, institucionet dhe entet publike, si dhe nga zyrat noteriale. Në përmbledhje, në kushtet kur asgjë në akte dhe as në pretendimet e subjektit nuk tregojnë qoftë edhe indicie të paragjyimit të mundshëm në procesin e kryer nga Komisioni, ky pretendim i subjektit rezulton i pambështetur në fakte dhe si një përpjekje për të ndërtuar mbrojtjen e saj në vijim mbi rrethana që anashkalojnë konkluzionet për kriterin e vlerësimit të pasurisë e kanë për synim delegjitimimin e procesit të kryer prej saj në kontekstin e themelit.

Në këtë konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit merr në konsideratë edhe faktin që ndryshe nga sa pretendon subjekti, Komisioni ka favorizuar subjektin e rivlerësimit duke çelur hetimin për të tria kriteret, ndonëse me analizën financiare të kryer në hetimin fillestar, vendimi mbi bazën e një kriteri, një ndër alternativat e parashikuara qartë nga ligji, ishte tagër dhe diskrecion, të cilin Komisioni vendosi të mos e ushtrojë. Së dyti, siç rezultojnë nga paragrafi 40.14 i vendimit objekt ankimi, Komisioni rezulton të ketë pranuar *pa asnjë arsyetim*, se si dhe mbi çfarë analize deduktoi që *subjekti arriti të shpjegojë të kundërtën e barrës së provës* për pasuritë e deklaruara

nga personi i lidhur, të krijuara tërësisht gjatë martesës<sup>24</sup>. Këto fakte, ndër të tjera, dëshmojnë për një qasje me tendenca tejet favorizuese për subjektin.

15.9. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit çmon se sipas ligjit nr. 84/2016, parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit i referohet vlerësimit në tërësi të çështjes dhe synon që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Në këtë kontekst, rezulton se Komisioni ka konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra si rrjedhojë e kësaj gjendjeje. Ndërsa pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për sa i përket këtij konkluzioni në themel shtjellohen gjerësisht më poshtë, në funksion të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit që lidhen me vlerësimin në themel të kriterit të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje në këtë pjesë të arsytimit që është i pabazuar edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit që masa disiplinore e shkarkimit zbatuar për të është disproporcionale. Nëse mbahet në konsideratë balanca negative e burimeve të ligjshme e konstatuar në vendimin përfundimtar të Komisionit, sikurse edhe konstatimi i referuar më sipër i qasjes favorizuese të treguar nga Komisioni, i cili ka pranuar shpjegimet e subjektit në prapësimin e barrës së provës, pa u ndalur në arsyetim për bazën ligjore dhe analizën sesi ajo gjen zbatim në rrethanat faktike të subjektit të rivlerësimit apo duke kryer një artific të pakuptimtë duke përjashtuar nga analiza fundore pasuritë e deklaruara nga personi i lidhur/bashkëshorti, krijuar gjatë martesës me subjektin<sup>25</sup> e për të cilat nuk ka regjim pasuror të ndarë, pretendimi i subjektit për të zbatuar proporcionalitetin është i pakuptimtë dhe përbën përpjekje për të minimizuar problemet e konstatuara në vlerësimin e saj pasuror edhe më tej.

## 16. *Pretendimet për zbatim të gabuar të ligjit*

16.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon më tej se Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi kjo dispozitë kërkon plotësimin kumulativ të dy kushteve: deklarimin e pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës sikurse edhe atë të pasurisë. Në këtë interpretim, subjekti potencon rregullat e teknikës legjislative për përdorimin e lidhëzës “dhe” të cilat diktojnë përmbushjen e të dy kushteve për zbatimin e kësaj pike të nenit 61. Subjekti, po ashtu, argumenton se ligjvënësi është detyruar të normojë pikën 4, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, prezumimin e pafajësisë për shkarkim, për rastin kur pasuria nuk e kalon dyfishin e pasurisë së ligjshme. Në rastin e saj, dukshëm, nuk rezulton të ketë pasuri më shumë se dyfishi i të ardhurave e, për rrjedhojë, penalizimi i saj, me masën ekstreme të shkarkimit nga detyra, përbën tejkalim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore.

16.2. Trupi gjykues sjell në vëmendje që ky argument i paraqitur edhe nga subjekti i rivlerësimit Nure Dreni, tashmë ka gjetur trajtim gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit<sup>26</sup>. Në analizë të argumenteve të ngritura nga subjekte të tjerë rivlerësimi, Kolegji ka theksuar se

---

<sup>24</sup> *Shih faqen 29 të vendimit të Komisionit dhe përmbledhjen e fakteve pasqyruar për këtë aspekt në faqet 21-29. <https://kpk.al/wp-content/uploads/2020/09/Vendim-Nure-Dreni.pdf>.*

<sup>25</sup> *Nga aktet në fashikull rezulton që martesa e subjektit me bashkëshortin daton para vitit 1990, ndërsa pasuritë e deklaruara nga personi i lidhur/bashkëshorti, janë krijuar duke filluar nga viti 2001.*

<sup>26</sup> *Shtjelluar, ndër të tjerë, në vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit A. Spaha (JR nr. 1/2021) dhe vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit Ç. Shahini (JR 26/2020).*

pavarësisht se deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë dhe figurës janë përmbledhur në normimin ligjor të pikës 3 të nenit 61, bazuar në përcaktimin e qartë që jep Aneksi i Kushtetutës, për këto dy kritere, interpretimi, sipas të cilit zbatimi i dispozitës duhet të jetë rrjedhojë e plotësisht të kriterëve kumulative, është i pasaktë. Deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë, sipas ligjit, konstatohet nën dritën e përcaktimeve kushtetuese të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Kjo dispozitë parashikon detyrimin për subjektin e rivlerësimit që të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Nga ana tjetër, deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës rregullohet në një nen të dedikuar të Aneksit të Kushtetutës, në nenin Dh. Në dritën e këtyre parashikimeve autonome të Aneksit të Kushtetutës, për këto dy kritere, deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës janë vlerësime autonome nga njëri-tjetri. Me fjalë të tjera, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, këto dy kritere nuk kërkojnë doemos praninë e njëri-tjetrit për t'u vërtetuar deklarimi i pamjaftueshëm.

**16.3.** Nga ana tjetër, pika 1 e nenit 61 e ligjit nr. 84/2016 përcakton rrethanat faktike dhe ligjore, po ashtu autonome nga rrethanat e tjera që normohen nga neni 61 e, konkretisht, ato në të cilat organet e rivlerësimit pa ushtruar diskrecion zbatojnë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra – kur subjekti i rivlerësimit *ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të*. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se masa disiplinore për shkarkimin e saj është jo proporcionale, meqenëse nuk gjendet në kushtet e deklarimit të dyfishit të pasurisë është i pambështetur në ligj. Në kushtet kur konstatimi i dyfishit të pasurisë së ligjshme është vetëm një ndër gjashtë (6) rrethanat ligjore të parashikuara nga neni 61 që passjellin shkarkimin, ndërsa masa disiplinore është marrë për deklarim të pasaktë e të pamjaftueshëm, parashikuar nga pika 3 e së njëjtës dispozitë e secila prej situatave ligjore mund të zbatohet veçmas, argumentimi i subjektit, bazuar në një prej rrethanave ligjore autonome e jokushtëzuese për zbatimin e të pesë (5) të tjerave, bazuar në radhën e zgjedhur nga ligjvënësi për të formuluar rrethanat juridike, duket i pabazuar.

**16.4.** Subjekti i rivlerësimit argumenton, po ashtu se, edhe nëse kushtet e parashikuara në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 nuk do të ishin kumulative, vlerësimi i Komisionit nuk e përlligj masën e shkarkimit nga detyra, pasi për konstatimin e deklarimit të pamjaftueshëm, sjellja e subjektit duhet të ketë të njëjtin nivel kundërligjshmërie sikurse janë shkeljet e renditura në pikat 1, 2, 4 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 – përkatësisht, dyfishi i pasurisë, probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, papërshtatshmëri të aftësive profesional apo cenim të besimit të publikut. Sipas subjektit, interpretimi i zgjeruar i parashikimeve të këtij neni mund të passjellë humbjen e efektit të normave të nenit D, pika 4 të Aneksit Kushtetutës.

**16.5.** Trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje jurisprudencën e konsoliduar dhe të harmonizuar, nëpërmjet së cilës këto dispozita kushtetuese e ligjore janë shtjelluar në mënyrë shteruese ndër vite, ndër të tjera, edhe për sa i përket rëndësisë që ka saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë për kontrollin e plotë dhe vlerësimin e drejtë të kriterit të pasurisë,



rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë<sup>27</sup>. Ky detyrim është zbatim i drejtpërdrejtë i kërkesave të normave kushtetuese dhe ligjore të posaçme për subjektet që kërkojnë të qëndrojnë në detyrë. Për më tepër, në analizë të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, edhe nga një lexim i thjeshtë i paragrafëve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, del qartë që secili prej tyre normon një situatë të caktuar gjatë procesit të rivlerësimit të subjekteve me elemente specifike dhe të pavarura, të cilat zbërthehen në përcaktimet e masave disiplinore, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit objekt ankimi, trupi gjykues i Kolegjit nuk konstaton që Komisioni të ketë kryer interpretim të zgjeruar të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Përkundrazi, situatat e përshkuara në vendim, mbështesin përfundimin e Komisionit për aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, që lidhet me deklarin e pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, referuar përcaktimeve të nenit 33 të po këtij ligji. Për sa më sipër, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pambështetur në ligj.

16.6. Subjekti i rivlerësimit, po ashtu në mbështetje të argumenteve të saj për gabime në interpretimin e ligjit nga Komisioni, pretendon se nuk gjendet në situatën e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 86/2016, pasi gjatë hetimit administrativ nuk ka rezultuar të jetë ngritur pretendimi për deklarin të rremë apo për fshehje pasurie. Deklarimet e saj kanë qenë të sakta dhe, për pasojë, ajo nuk gjendet në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, gjerat “c” e “ç” të ligjit nr. 84/2016.

16.7. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Shkaqet mbi bazën e të cilave mund të jepet masa e shkarkimit nga detyra për kriterin e pasurisë janë ato të parashikuara nga neni 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, të cilat rrjedhin nga situata specifike të caktuara e të ndryshme. Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të pasurisë, për shkak të pamundësisë për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet e kryera dhe kursimet e deklaruara, që në vlerën përfundimtare kanë rezultuar me një balancë negative prej (-) 2.786.519 lekësh. Subjektet e rivlerësimit ngarkohen me përgjegjësi disiplinore, nëse, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose nëse nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Konkluzionet se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta dhe se nuk ka provuar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të pretenduara kanë përbërë mjaftueshëm elementë për Komisionin, për të konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e deklarin të pamjaftueshëm, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Nga ana tjetër, situata e deklarin të rremë apo e fshehjes së pasurisë, përbëjnë një kualifikim ligjor të ndryshëm nga mungesa e burimeve të ligjshme, si pasojë e të cilës për subjektin është marra masa disiplinore e shkarkimit. Sikurse shtjelluar më sipër, kjo situatë është autonome nga ato të argumentuara nga subjekti dhe parashikohet si një germë më vete në neni 33, pika 5, krahas rrethanës ligjore të fshehjes, deklarin të rremë, deklarin të pasaktë apo konfliktit të interesit. Me fjalë të tjera, sikurse paragrafi 1 i nenit 61 nuk përbën kriter mbi të cilin bazohen konstatimet në vijim të asaj dispozite edhe situata e mungesës së

---

<sup>27</sup> *Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit Xh. Zaganjori [nr. 19/2019].*

burimeve nuk kushtëzohet nga konstatimi i ekzistencës së ndonjë rrethane tjetër ligjore përshkruar në të njëjtën dispozitë. Ky fakt është i qartë, qoftë në lexim të thjeshtë literal të nenit 33, pika 5, qoftë në një arsyetim logjik edhe të përciptë që mban parasysh ndryshimet konceptuale mes secilës prej germave të pikës 5. Për të gjitha këto arsye, trupi gjykues vlerëson se edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pambështetur në ligj.

16.8. Në përmbledhje të të gjithë argumenteve të shtjelluara më sipër, duke pasur parasysh edhe zbërthimin e parimeve të procesit të rregullt ligjor referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese<sup>28</sup> dhe GjEDNj-së<sup>29</sup>, mbi gjykimin kontradiktor dhe barazinë e armëve, për rëndësinë e veçantë që merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e arsyeshme që u jepet palëve për të paraqitur provat dhe vlerësimet ligjore të lidhura me çështjen që shqyrtohet, sikurse e ka trajtuar edhe subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që pretendimet e subjektit se Komisioni ka cenuar parimet e procesit të rregullt nuk qëndrojnë. Pa ripërsëritur sa është arsyetuar gjerësisht më sipër, këto pretendimet rezultojnë të pambështetura në ligj apo aktet në fashikull. Subjektit të rivlerësimit i është dhënë mundësia të ushtrojë të gjitha të drejtat e saj për proces të rregullt. Po ashtu, interpretimi i Kushtetutës dhe ligjit nga Komisioni, për gjithë aspektet e analizuara më sipër, rezulton i drejtë.

### C. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë

17. Për sa i përket rivlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi nuk mbështetet në prova dhe se në analizën financiare të kryer nga Komisioni nuk janë vlerësuar fakte që rezultojnë nga provat dhe deklaratimet e saj gjatë procesit administrativ. Subjekti i rivlerësimit ka detajuar pretendimet e saj mbi analizën financiare të kryer nga Komisioni për secilin vit, duke dhënë argumentet për *korrigjimin* e vlerave në zëra specifikë. Në përfundim, pasi ka argumentuar për balanca pozitive, subjekti parashtron se të ardhurat e realizuara nga ajo dhe personat e lidhur mbulojnë të gjitha shpenzimet familjare. Provat dhe shpjegimet e saj, paraqitur gjatë hetimit administrativ, mbështesin pretendimet e saj, të cilat janë pasqyruar edhe në aktin e ekspertimit të datës 20.11.2019 të shoqërisë audituese “{\*\*\*}”.

17.1. Pasi analizoi shkaqet e ankimit dhe aktet në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore të zbatueshme, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Analiza financiare e kryer nga Kolegji, në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit, përkundër pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, konfirmon balancën negative të konstatuar nga Komisioni. Subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të kryer shpenzimet e kryera, parashikuar në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Një arsyetim i detajuar i këtij konkluzioni shtjellohet në vijim, duke ndjekur radhën e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim. Nga ana tjetër, analiza e pretendimeve në ankim për zëra shpenzimesh, të cilët gjejnë zbatim në secilin nga katër vitet me balancë negative në vendimin e Komisionit, shtjellohet e grupuar tematikisht për të evituar përsëritjen.

<sup>28</sup> Shih vendimin nr. 21, datë 16.04.2015; vendimin nr. 34, datë 29.05.2015; vendimin nr. 37, datë 30.06.2016, etj.

<sup>29</sup> Shih Ruiz-Mateos kundër Spanjës; McMichael kundër Mbretërisë së Bashkuar; Vermeulen kundër Belgjikës; Lobo Machado kundër Portugalisë; Kress kundër Francës, etj.

## 18. Për pasurinë automjet, “Citroen C3”

18.1. Pasi vlerësoi provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti ka pasur mundësi financiare në momentin e pagesës së kështit të parë të pasurisë autoveturë “Citroen C3” në shumën 6.900 euro, por ka kryer deklarim të pasaktë të burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit [vetting]. Ndërsa në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat e vitit, në deklaratën vetting ka përcaktuar si burim të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur/bashkëshorti, si rrjedhojë e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor<sup>30</sup>. Komisioni ka konstatuar se subjekti ka deklaruar një burim financiar, i cili nuk ishte krijuar ende, pasi shuma nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, datë 14.05.2010, nuk mund të shërbente për krijimin e kësaj pasurie.

18.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e mësipërm të Komisionit me argumentin se pagesa e kryer, për blerjen e automjetit në fjalë, në shumën 6.900 euro në shkurt 2010, është kryer me para në dorë [cash]. Këto para janë zëvendësuar menjëherë nga paratë e fituara nga ekzekutimi i vendimit të gjykatës, më datë 14.05.2010. Në këtë mënyrë, gjendja cash në atë vit është e pandryshuar e, për rrjedhojë, ka deklaruar në deklaratën e pasurisë se burim i të ardhurave për blerjen e këtij automjeti është edhe vendimi gjyqësor.

18.3. Nga aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në deklaratën vetting, për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar krijimin në vitin 2010 [...] sipas kontratës së shitblerjes [...] datë 06.02.2013 [...] dhe si burim i krijimit [...] me kredi në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, sipas kontratës [...] datë 16.02.2010 dhe nga të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti [...], rrjedhojë e ekzekutimit të vendimit gjyqësor [...] datë 17.07.2009 [...] ekzekutuar nga zyra e përmbarrimit më datë 14.05.2010 [...], Vlera [...] 13.800 [...] euro.

18.4. Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit, përpos të dhënave të sipërcituara, lidhur me datën e blerjes, markën e automjetit dhe pjesën takuese, ka deklaruar edhe burimin e krijimit [...] nga të ardhurat e këtij viti [...]. Vlera: 6.900 (gjashtëmijë e nëntëqind) euro. Në të njëjtën deklaratë periodike, në rubrikën dedikuar deklarimit të të ardhurave nga angazhime në veprimtari publike dhe private, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, shumën e përfituar dhe datën e ekzekutimit [14.05.2010].

18.5. Në përfundim të hetimit administrativ, për këtë pasuri, pasi kreu analizën financiare për harkun kohor nga 1 janari 2010 deri në datën e blerjes së mjetit më 9 shkurt 2010, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 773.719 lekë, për pagesën e kështit të parë të automjetit “Citroen C3”, sipas burimit të deklaruar. Pas shpjegimeve të subjektit pas kalimit të barrës së provës, duket se Komisioni ka marrë në konsideratë sasinë e gjendjes cash në vitin 2010. Po ashtu, Komisioni ka konkluduar se të ardhurat e përfituara nga ekzekutimi i vendimit të gjykatës, në vlerën 2.170.195 lekë, kanë

---

<sup>30</sup> Vendimi nr. {\*\*\*}, datë 17.7.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me anën e të cilit personi i lidhur ka fituar dëmshpërblim nga ish-punëdhënësi për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit të zgjidhjes së marrëdhënies së punës në vitin 2008.

shërbyer për likuidimin e kësteve të kredisë së këtij automjeti më pas. Përfundimisht, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka pasur mundësi financiare në momentin e pagesës së kështit të parë të pasurisë autoveturë “Citroen C3”, në shumën 6.900 euro.

18.6. Në analizën e kryer nga trupi gjykues i Kolegjit për këtë shkak ankimi, në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit, subjekti rezultoi me pamundësi financiare për të kryer pagesën prej 6.900 eurosh nga të ardhurat e vitit 2010, siç edhe ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2010. Pavarësisht nga ky konstatim, në zbatim të parimit të mospërkeqësimit të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit, për deklarim të pasaktë të burimit të krijimit të pasurisë, qëndron. Në kushtet kur shpërblimi financiar, në zbatim të vendimit të gjykatës është materializuar në llogarinë bankare të personit të lidhur tre (3) muaj pas transaksionit të shitblerjes së automjetit objekt analize, pretendimet e subjektit të rivlerësimit që tentojnë të justifikojnë këtë deklarim, si derivat i një mënyre të caktuar që bazohet në *gjendjen cash të pandryshuar*, bie ndesh me udhëzimet konkrete të Shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë të fundit, subjekteve u kërkohet në mënyrë specifike të deklarojnë burimin e krijimit të të ardhurave dhe jo gjendja e *cash*-it. Formulari, po ashtu, nuk lë vend për interpretime të tjera, siç pretendon subjekti i rivlerësimit.

18.7. Mbetet fakt i pakontestueshëm që burim krijimi i pasurisë automjet nuk mund të ishte shpërblimi sipas vendimit të gjykatës, sikurse edhe që në deklaratën e kohës [DIPV-në për 2010] subjekti ka deklaruar kursimet e vitit përkatës apo një burim tjetër krijimi. Për sa më sipër, deklarimi i subjektit për burimin e krijimit nuk është i vërtetë. Për pasojë, dhe nën dritën e nevojës për mospërkeqësim të situatës së subjektit në ankim, konfirmohet përfundimi i Komisionit. Subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën *vetting*, sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Të ardhurat e deklaruara si burim janë fituar dhe disponuar nga personi i lidhur vetëm tre muaj pasi është krijuar pasuria, në 14 maj 2010, nga ekzekutimi i një vendimi gjyqësor.

18.8. Nga ana tjetër, nga përmbajtja e vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se nuk rezulton që ky shkak ankimi i parashtruar nga subjekti të jetë bërë pjesë e vlerësimit përfundimtar për kriterin e vlerësimit të pasurisë apo në funksion të masës disiplinore. Me fjalë të tjera, ndonëse është pasqyruar në një vlerësim të kryer përgjatë vendimit<sup>31</sup> në përmbyllje të analizës për këtë pasuri, ky konkluzion mungon në përmbyllje të vlerësimit të kriterit të pasurisë në vendimin objekt ankimi<sup>32</sup>, që ka konkluduar për subjektin vetëm gjendjen në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 – mungesë burimesh të ligjshme në vlerën prej (-) 2.786.519 lekësh dhe që fokusohet vetëm në vitet 2011 – 2014. Deklarimi i pasaktë për kriterin e vlerësimit të pasurisë, jo vetëm që nuk pasqyrohet në konkluzionin përfundimtar, por edhe nuk rezulton të ketë qenë shkak shkarkimi për subjektin. Kjo kontradiktë duket të jetë edhe arsyeja për të cilën konkluzioni për deklarim të pasaktë për këtë pasuri është pjesë e shkaqeve të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit. Në kushtet kur ky konkluzion *i ndërmjetëm* i Komisionit nuk rezulton të jetë pjesë integrale e vlerësimit

---

<sup>31</sup> Shih paragrafin 27 të vendimit të Komisionit, faqe 5, <https://kpk.al/wp-content/uploads/2020/09/Vendim-Nure-Dreni.pdf>.

<sup>32</sup> Paragrafi 41 i vendimit të Komisionit, si më sipër.

përfundimtar për pasurinë në vendimin objekt ankimi, trupi gjykues i Kolegjit çmoi të mos i atribuojë vlerë përcaktuese në zgjidhjen e çështjes në Kolegj.

19. *Analiza financiare për katër vite të periudhës së rivlerësimit, 2011 - 2014*

19.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit se ajo dhe personat e lidhur kanë pamjaftueshmëri financiare për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzimet e tjera familjare, duke rezultuar me bilanc negativ në vlerën (-) 2.786.519 për periudhën e rivlerësuar, vitet 2003-2016, me fokus vitet 2011-2014. Subjekti argumenton se një analizë e saktë, bazuar në pretendimet e saj, do të rezultonte në kushtet e mjaftueshmërisë financiare të saj dhe personave të lidhur për të përballuar/mbuluar shpenzimet. Të përmbledhura, pretendimet e subjektit të rivlerësimit me fokus analizën financiare, fokusohen në kërkimin për të përfshirë të ardhura, përpos atyre të cilët ka përfshirë Komisioni, siç janë dietat e përfituara nga bashkëshorti gjatë detyrës – e që përfshijnë gjithë vitet objekt ankimi – si dhe zbritjen e shpenzimeve të caktuara, siç janë shpenzimet e jetesës, të udhëtimit jashtë Shqipërisë apo të shkollimit për personat e lidhur [vajzat e subjektit]. Po ashtu, kërkimet e subjektit fokusohen në rillogaritje të *cash*-it jashtë sistemit bankar, sipas deklaratave periodike vjetore – me fokus DIPP-të e plotësuar prej saj në vitet 2013 dhe 2014 dhe gjendjen e llogarisë bankare të njëres prej vajzave në Britaninë e Madhe – dhe rillogaritje kursi këmbimi të GBP britanik në lekë, për llogarinë bankare të vajzës në Britaninë e Madhe.

19.2. Pasi shqyrtoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, përkundër analizës financiare të Komisionit në vendim, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se balanca negative e përftuar pas rillogaritjes së zërave të shpenzimeve, duke iu përmbajtur parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit<sup>33</sup>, pëson një ndryshim thuajse të papërfillshëm. Konkretisht, nga analiza financiare e kryer në Kolegj në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit, balanca negative prej (-) 2.786.521 lekësh, reduktohet me 52.512 lekë e konkretisht në (-) 2.734.009 lekë. Ky ndryshim vjen si pasojë e korigjimit të disa shpenzimeve të udhëtimit [vitet 2011, 2012 dhe 2013] dhe rillogaritjen e likuiditeteve, sipas konfirmave bankare [në vitin 2011].

19.3. Nga ana tjetër, trupi gjykues i çmon të pabazuara disa nga pretendimet e subjektit për zëra të caktuar. Në vijim, shtjellohet arsyeimi, që qëndron në themel të këtij konkluzioni të trupit gjykues, duke marrë në analizë fillimisht argumentet që gjejnë zbatim për të gjithë vitet e më pas duke konkluduar për pretendime që fokusohen në zëra specifikë të secilit vit.

*i. Dietat e përfituara nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit*

19.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon se dietat e shërbimeve të kryera nga bashkëshorti i saj duhet të përfshihen në të ardhura dhe, njëkohësisht, të zbriten shpenzimeve vjetore jetike për këtë pjesëtar të familjes dhe referon, në mbështetje të pretendimit të saj, vendimin nr. 977/2010, të Këshillit të Ministrave<sup>34</sup>. Subjekti pretendon se Komisioni ka rillogaritur shpenzime shtesë

<sup>33</sup> Nëse analiza financiare do të kryhej sipas metodologjisë së Kolegjit në Komision, balanca negative për këto vite do të thellohej e, konkretisht, në vlerën (-) 3.214.659 lekë.

<sup>34</sup> “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”: [...] Dietë ditore, e cila për çdo punonjës të dërguar me shërbim, llogaritet: (i) në masën 1.000 (një mijë) lekë në ditë, kur punonjësi kthehet brenda ditës; (ii) në masën 10 për qind të pagës mujore, por jo më shumë se 2.500 (dy mijë

jetese, sipas ILDKPKI-së, në vlerën më të lartë se sa ishin llogaritur në raportin e hetimit administrativ, analizën financiare (nëntor 2011).

19.5. Nga akte në fashikull, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjatë hetimit administrativ një vërtetim, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor që mban datën 15.03.2019, ku konfirmohet që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka përfitur në formën e dietave për shpenzimet e kryera si punonjës i auditit, si pjesë e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor gjatë periudhës shkurt 2009-shtator 2013. Shkresa specifikon shumën e të ardhurave të përfituara në formën e dietave për shërbime nga personi i lidhur për secilin vit objekt analize.

19.6. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se nga ky dokument provohen shërbimet jashtë qytetit të banimit të personit të lidhur për një numër ditësh në secilin prej këtyre viteve<sup>35</sup>, ndërsa nuk mund të deduktohet që ditët e shërbimit kanë qenë pa shkëputje, fakt i cili teorikisht mund të passillte një analizë në drejtim të zbritjes së shpenzimeve familjare për periudhën kohore në fjalë. Përpos këtij fakti, të ardhurat e akorduara në formën e dietave shërbejnë për t'i mundësuar punonjësve shpenzimet incidentale gjatë ditës. Për këtë arsye, siç është shtjelluar gjerësisht edhe nga vendime të mëparshme të Kolegjit<sup>36</sup>, efekti financiar i dietave, në kushtet kur ato kanë për qëllim të mbulojnë shpenzimet ditore të shoqëruara me largësinë nga vendbanimi, është i papërfillshëm.

19.7. Nga ana tjetër, shpenzimet jetike familjare përfshijnë çdo lloj shpenzimi për blerje produktesh apo shërbimesh, të cilat shoqërojnë nevojat individuale të anëtarëve të familjes. Struktura e tyre nuk përbëhet vetëm nga shpenzimet për ushqim, por përmbledh 12 grupe kryesore të shpenzimeve të konsumit, si: shpenzime për ujë, energji elektrike, veshje, mallra dhe shërbime, mirëmbajtje banese etj. Në këtë kuptim, shpenzimet ditore të jetesës të përlllogaritura nga institucionet e rivlerësimit, sipas standardit të INSTAT-it ndër vite e që bazohen në një fashë ekonomike nën nivelin e atyre të magjistratëve dhe familjet me nevoja dhe të ardhura bazike, nuk mund të argumentohet se duhet të reduktohen, më tej, për shkak të pagesës për të mbuluar shpenzimet gjatë udhëtimeve të punës jashtë vendbanimit. Ndërkohë, koncepti i shpenzimeve jetike, si zë i rëndësishëm i analizës financiare, nënkupton shpenzimet bazike të jetesës së një familjeje në një vendbanim të përbashkët, të cilat nuk ndikohen nga lëvizja një apo disa ditore e njërit apo disa prej pjesëtarëve të familjes.

---

*e pesëqind) lekë në ditë, kur shërbimi zgjat më shumë se një ditë. Për efekt të llogaritjes së dietës, në këtë rast, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten një ditë e plotë. b) Shpenzimet e fjetjes kundrejt dokumentit tatimor përkatës të paraqitur nga hoteli e të shoqëruar me faturën e printuar nga kasa elektronike fiskale, por jo më shumë se 3.000 (tre mijë) lekë, për çdo natë [...], duke u bazuar në shkallën e pagesës (shumë e përfitur në formën e dietës në shumën 305.000 lekë).*

<sup>35</sup> Konkretisht, nga shkresa e KLGj-së rezulton se personi i lidhur në vitin 2011 ka qenë 71 ditë me shërbim jashtë vendbanimit, në vitin 2012 gjithsej 76 ditë jashtë vendbanimit, në vitin 2013 gjithsej 51 ditë, si dhe në vitin 2014, gjithsej 88 ditë.

<sup>36</sup> Shih vendimin e Kolegjit që lidhet me subjektin e rivlerësimit Elison Sadiku [JR nr. 07/2019], paragrafët 34 dhe 36, vendimin që lidhet me subjektin e rivlerësimit Admir Belishta [JR nr. 01/2020], paragrafi 15, vendimin që lidhet me subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj [JR nr. 04/2020], paragrafi 61, vendimin që lidhet me subjektin e rivlerësimit Albina Spaha [JR nr.1/2021], paragrafi 27.7/c dhe vendimin që lidhet me subjektin e rivlerësimit Enkelejdi Hajro [JR nr.3/2021], paragrafi 74.

19.8. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit i konstatoi të pabazuara kërkimet e subjektit të rivlerësimit për të përfshirë në burimet e ligjshme për përballimin e shpenzimeve të saj dhe të personave të lidhur dietat e bashkëshortit dhe zbritjen e shpenzimeve për një person nga shpenzimet jetike. Ky vlerësim gjen zbatim për të katër vitet objekt analize, për të cilët pretendimet e subjektit janë të njëjta dhe fokusohen mbi të njëjtin akt të sjellë prej saj në cilësinë e provës.

*ii. Përlllogaritja e shpenzimeve të udhëtimit*

19.9. Subjekti pretendon se vlera e llogaritur nga Komisioni në përcaktimin e shpenzimeve të udhëtimit është në disfavorin e saj, pasi është njohur me vlerat e shpenzimeve të udhëtimit të saj dhe personave të lidhur vetëm në vendimin e arsyetuar dhe, si pasojë, nuk ka pasur mundësi të debatonte dhe jepte shpjegime mbi këtë fakt.

19.10. Nga aktet në fashikull rezulton se Komisioni ka konkluduar të kryejë rillogaritjen e udhëtimeve, pasi ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit dhe duke përdorur çmimet e biletave të paraqitura prej saj në datën 12.03.2019<sup>37</sup>. Në këtë datë, në përgjigje të pyetësorit për sa i përket shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit, rezulton që përpos sqarimeve të hollësishme mbi udhëtimet jashtë vendit, si dhe mënyrën e transportit, bashkëlidhur *e-mail-it*, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit kopje të biletave të udhëtimit me çmimet përkatëse. Në rezultatet e hetimit administrativ, përcjellë subjektit, Komisioni i ka llogaritur shpenzimet e udhëtimit të subjektit dhe personave të lidhur për secilin vit, vlera të cilat kanë pësuar ndryshime pas shpjegimeve të përcjella nga subjekti. Përfundimisht, për secilin vit, Komisioni ka përlllogaritur shpenzime udhëtimi, pasi ka reflektuar provat shkresore të subjektit, të cilat kanë afektuar vlerën e shpenzimeve në rritje vetëm për tri vitet e para objekt analize [2011-2013], përkatësisht: me 5.020 lekë më shumë, 10.502 lekë më shumë dhe 12.266 lekë më shumë. Vlera e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2014 ka mbetur e pandryshuar. Në total, këto reflektime në vendimin e Komisionit, kanë një efekt financiar prej 27.788 lekësh për tri vite.

19.11. Në analizë të fakteve të mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vëren se kjo rritje minimaliste e vlerave të shpenzimeve të udhëtimit të subjektit dhe personave të lidhur në analizën përfundimtare të kryer nga Komisioni, që bazohet në çmimet e biletave të dorëzuara dhe kërkuara të merren në cilësinë e provës nga vetë subjekti, nuk mbështet pretendimet e subjektit dhe as nuk mund të përbëjë argument për të ndryshuar vendimin e Komisionit. Pretendimi i subjektit, nga ana tjetër, është i pabazuar. Konkretisht, subjekti kërkon që të korrigjohet vlera e përfutur si pasojë e kërkesës së ushtruar prej saj, mbi bazën e çmimeve të referuara në korrespondencë të sjellë po prej saj, për një vlerë të papërfillshme në kontekstin e balancës negative në total, duke përdorur vlera të hamendësuara, meqenëse situata faktike pas kërkesës së saj ka rezultuar e disfavorshme, ndonëse ky kërkim, në të kundërtën e saj është kërkuar prej saj, në pikën fundore do të kishte një peshë minimale.

---

<sup>37</sup> Paragrafi 30.4.1, faqe 8 e vendimit objekt ankimi, ku Komisioni shprehet se: “[...] pasi analizoi kërkesën e subjektit dhe dokumentacionin e paraqitur gjatë hetimit administrativ, arrin në përfundimin të kryejë rillogaritjen në analizën financiare për zërin e udhëtimeve, duke u bazuar në çmimin real për të gjitha biletat e udhëtimit të cilat janë paraqitur nga subjekti nëpërmjet postës elektronike”.

Në përmbledhje të sa më sipër, për sa kohë në vlerat e llogaritura nga Komisioni në vendimin përfundimtar janë pasqyruar çmimet e biletave të paraqitura si provë nga vetë subjekti, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit se Komisioni ka llogaritur shpenzimet e udhëtimit në disfavor të saj është i pabazuar. Për të evituar përsëritjen në vijim, ky arsyetim gjen zbatim për të gjitha vitet në të cilat subjekti ka ngritur shkak ankimi ndryshimin e vlerave, sipas shpjegimeve të dhëna prej saj.

**19.12.** Përpos sa është analizuar më sipër, për vitet për të cilat Komisioni ka konstatuar balanca negative, në vijim shtjellohen në detaj pretendimet e subjektit të rivlerësimit me fokus zëra të analizës financiare për vitet 2011 – 2014, për të cilat pretendimet janë specifike.

*iii. Lidhur me shpenzimet e jetesës*

20. Subjekti i rivlerësimit konteston për gjithë vitet, për të cilat ka rezultuar me balancë negative, përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës me fokus ato që i përkasin periudhave kohore të udhëtimeve familjare jashtë shtetit apo për periudhat kur vajza ka qenë në Shqipëri gjatë pushimeve të shkollës që ndiqte në Britaninë e Madhe. Konkretisht, subjekti kërkon që të zbriten shpenzime jetese në Shqipëri për tri (3) muaj në vitet 2011 dhe 2012 dhe për një (1) muaj për vitet 2013 dhe 2014, duke përlllogaritur shpenzime për një familje me më pak se katër (4) persona. Po ashtu, subjekti kundërshton edhe përlllogaritjen e shpenzimeve të shkollimit në Shqipëri për vajzën tjetër [G. D.], në vitet 2011, 2012 dhe 2013. Subjekti potencon se, meqenëse është fjalë për shkollim në një institucion publik, këto shpenzime duhet të konsiderohen të përfshira e përlllogaritura në shpenzimet jetike.

**20.1.** Nga analiza e akteve në fashikull, përkundër pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar, përveçse i pakuptimtë. Ky konkluzion mban në konsideratë, faktin që vlera e shpenzimeve të jetesës në Britaninë e Madhe është zbritur me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, qartazi pasi përlllogaritja ishte në favor të situatës së saj financiare. Për pasojë, ulja e shpenzimeve jetike në njërin zë [që përkon me shpenzimet sipas standardit zyrtar të Britanisë së Madhe] dhe shtimi i një vlere më të ulët, të cilës i korrespondon shpenzimi për person, sipas standardit zyrtar të INSTAT-it në Shqipëri në zërin përkatës, është derivat i natyrshëm i logjikës së propozuar nga subjekti dhe pranuar nga Komisioni. Me fjalë të tjera, subjekti është dakord me pranimin e kërkesës, por jo me pasojat e logjikshme që ajo sjell në zbatimin e saj korrekt e logjik. Nga analizimi i vendimit të Komisionit, rezulton se në përgjigje të kërkesës së subjektit të rivlerësimit Komisioni ka vendosur të zbresë shpenzimet në Britaninë e Madhe dhe ka llogaritur shpenzime jetike në Shqipëri, për periudhën kohore përkatëse për të gjitha vitet objekt analize. Për shkak të këtij veprimi, për periudhën 2011-2014, shpenzimet e jetesës në Shqipëri, pas kërkesës së subjektit, për shkak të përlllogaritjes së familjes me pesë (5) persona, janë shtuar me vlerën **171.051** lekë, por ajo që është më e rëndësishme, janë *pakësuar* ndjeshëm shpenzimet e përlllogaritura në Britaninë e Madhe, krahasuar me bilancin negativ të përcjellë me rezultatet e hetimit me **2.650.424** lekë. Kjo zbritje përbën edhe arsyen kryesore të diferencës së bilanceve negative mes këtyre dy momenteve në procesin e kryer në Komision. Në kushtet kur në thelb, pretendimi i subjektit për këtë zë të analizës financiare ka për synim thjesht zbritjen e mëtejshme të shpenzimeve të jetesës – të cilat siç arsyetohet gjerësisht në këtë vendim janë bazike dhe përfshijnë gjithë fashat e shoqërisë shqiptare, përfshirë edhe ato në nevojë – në



drejtim të përmirësimit të situatës së mungesës së burimeve të ligjshme në të cilën ajo është konstatuar, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson këtë kërkesë të pakuptimtë.

**20.2.** Në këtë vlerësim, trupi gjykues çmon të shtojë edhe që shpenzimet që shoqërojnë kohën e qëndrimit të vajzës së subjektit në Shqipëri përfshin çdo lloj shpenzimi për blerje produktesh apo shërbimesh për të plotësuar nevojat individuale të anëtarëve të familjes. Për sa i përket anës tjetër të këtij aspekti, sipas publikimeve të INSTAT-it, bazuar në të dhënat në bazë anketash të kryera në të gjithë territorin e Shqipërisë, shpenzimet mujore përbëjnë totalin e shpenzimeve të disa grupeve të konsumit. Referuar tipologjisë së nëngrupeve të konsumit, konstatohet se një pjesë e shpenzimeve nuk afektohen nga udhëtimet disaditore që subjekti i rivlerësimit/familja e saj ka kryer, pasi janë shpenzime të cilat vazhdojnë e gjenerohen. Në kushtet kur shpenzimet mujore të përdorura si referencë, përfshijnë të dhëna nga anketimet për konsumin mujor mesatar të kryer nga familjet me nivele të ndryshme të ardhurash, si emërues i përbashkët që përfshin gjithë fashat e pagave dhe përfitimeve në Republikën e Shqipërisë, trupi gjykues çmon se shpenzimet e jetesës që përdoren nga institucionet e rivlerësimit, në funksion të analizës financiare për subjektet e rivlerësimit, përbëjnë një zgjedhje tejet garantiste. Në këtë kuptim, krahasimi që kryen subjekti i rivlerësimit, lidhur me shpenzimet ditore të jetesës të përlllogaritura, sipas standardit të INSTAT-it, me vlerën e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, është i pabazuar dhe joreal.

**20.3.** Së fundmi, në lidhje me pretendimin se shpenzimet për arsim publik janë përfshirë në shpenzimet jetike e, si të tilla, duhet të mos përbëjnë zë më vete në analizën financiare, përpos analizës së mësipërme të zgjeruar për vlerat minimale të përlllogaritura për shpenzime jetese nga institucionet e rivlerësimit, trupi gjykues sjell në vëmendje disa aspekte. *Së pari*, shpenzimet e përlllogaritura nga INSTAT janë shpenzime minimale, konkretisht “Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës” përlllogarit shpenzimet e minimumit jetik<sup>38</sup>. *Së dyti*, nga publikimet e INSTAT-it në faqen zyrtare, që mbulojnë vitet 2009 dhe 2014, rezulton se shpenzimet e arsimit përbëjnë 3.10% të shpenzimeve vjetore për një person ose 4.232 lekë. Nga ana tjetër, sipas akteve në fashikull, vlera prej 30.000 lekësh, shpenzuar për arsimimin e vajzës, për vitin 2011, vlera prej 60.000 lekësh në vitin 2012 dhe 60.000 lekësh në vitin 2013, është konsiderueshëm disafish më e lartë. Pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër, për standardin e shpenzimeve sipas INSTAT-it, këto shpenzime përlllogaritën në mungesë të të dhënave specifike e dokumentare për shpenzime të tjera. Në kushtet kur Komisioni ka dokumentacion ligjor që provon ekzistencën e këtij shpenzimi, përforcuar më tej edhe nga akti i ekspertimit të paraqitur nga subjekti në Komision<sup>39</sup>, në prapësim të rezultateve të hetimit, edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar dhe alogjik, pasi nëpërmjet tij kërkon të mos merren në konsideratë shpenzime të specifikuar prej asaj vetë në përgjigje të barrës së provës për vlerësimin e kriterit të pasurisë. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se edhe kërkimi për zbritjen e këtij zëri shpenzimesh është përpjekje e subjektit për të minimizuar më tej balancën negative të konstatuar në konkluzionin e Komisionit dhe nuk pasqyron një përshkrim të vërtetë të fakteve.

<sup>38</sup> Referuar publikimit të INSTAT, *Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës – {\*\*\*}*, *Manuali i Anketuesit: “Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) do të kryhet në kuadrin e monitorimit të vazhdueshëm të varfërisë dhe krijimit të një sistemi të vlerësimit të politikave në kontekstin e Strategjisë së Qeverisë Shqiptare për Rritjen ekonomike dhe Reduktimin e Varfërisë”*.

<sup>39</sup> *Akt ekspertimi financiar i përgatitur nga studio “{\*\*\*}”, më datë 20/11/2019, parashtruar nga subjekti i rivlerësimit në Komision, në faqen 23.*

iv. *Shpenzimet e shkollimit të personit të lidhur [vajzës së subjektit], në Britaninë e Madhe*

21. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për deklarime kontradiktore të shpenzimeve të shkollimit të vajzave në Britaninë e Madhe mbi vlerat e shpenzimeve, për studimet e njëjës prej vajzave në vitet 2011-2013, si dhe të dy vajzave në vitin 2014. Komisioni keqinterpretonte shpjegimet e dhëna prej saj në pyetësorë, përfshirë edhe atë nr. 1<sup>40</sup>. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, ka pasqyruar shumën 13.380 GBP, por jo shpenzimet e tjera për jetesën, ndërsa në pyetësor ka deklaruar dhe shpenzimet e tjera të jetesës, të cilat, sipas subjektit, janë në vlerën 2.000 GBP. Në përgjigje të pyetësorëve ka deklaruar shpjegime shkollimi, qiraje dhe shpenzime jetese të vajzës [A. D.] për vitin 2011, ndërsa në deklaratën e interesave periodike të vitit 2013 ka deklaruar vetëm shpenzimet e shkollimit dhe qirasë, pasi shpenzimet për ushqim dhe jetesë nuk kanë qenë të deklarueshme, sipas përkufizimit të ligjit nr. 9049/2003. Lidhur me shpenzimet e kryera për shkollimin dhe qëndrimin e të dy vajzave në Britaninë e Madhe [për vitin 2014], konkluzioni i Komisionit në pikën 33.9 të vendimit se ka marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2014 është i pasaktë. Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, referuar konkretisht pikës 33.21 të vendimit, konstatohet lehtësisht se në fakt janë marrë në konsideratë deklaratimet e dhëna në përgjigje të pyetësorëve mbi shpenzimet për studim, qira dhe të tjera jetese për vajzat e saj dhe jo deklaratimet në DPV-në e vitit 2014. Për këto arsye, subjekti e konsideron cilësimin e kryer nga Komisioni si qasje *favorizuese*, të pasaktë e të padrejtë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit parashtron probleme lidhur me kursin e këmbimit të përdorur, që, sipas saj, afekton analizën financiare për vitin 2011<sup>41</sup>.

21.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se aktet në fashikull tregojnë që termi *skenar favorizues*, referuar nga Komisioni në vendim, është i pasaktë. Në kushtet që vlera e shpenzimeve të shkollimit për të katër vitet<sup>42</sup>, aplikuar në analizën financiare, pasqyron ato të specifikuar nga subjekti gjatë pyetësorëve dhe jo të përfuara si rezultat i ndonjë arsytimi garantist nga Komisioni, ky pretendim i subjektit është i bazuar. Pavarësisht këtij konstatimi, në kushtet kur zërat e shpenzimeve të shkollimit, qirasë dhe të jetesës në Britaninë e Madhe mbeten të njëjtë, trupi gjykues e vlerëson pa efekt këtë pretendim të subjektit dhe nuk çmon të elaborojë më tej në këtë drejtim.

21.2. Pavarësisht nga sa më sipër, trupi gjykues çmon të theksojë se Komisioni ka reduktuar ndjeshëm balancën negative të vitit 2013, në vendimin përfundimtar krahasuar me rezultatet e hetimit paraprak, duke mos përllogaritur shpenzime jetese për qiranë e paguar prej vajzës në Britaninë e Madhe. Si rrjedhojë, balanca negative e vitit në vendimin objekt ankimi është ulur ndjeshëm nga (-) 638.736 lekë, në vlerën (-) 300.309 lekë.

---

<sup>40</sup> Në faqen 3-4 në të cilin është pasqyruar si vijon: “Gjatë vitit kalendarik 2011 janë shpenzuar/kryer pagesa për studim, vlera në shumën 10.800 GBP në {\*\*\*}, për qira banese (dhome) në vlerën 2.580 GBP, shpenzime të tjera për jetesën shuma 2.000 GBP”.

<sup>41</sup> Sipas subjektit, në përllogaritjen e pakësimit të likuiditeteve, në analizën për vitin 2011, Komisioni ka aplikuar kurse të ndryshme këmbimi për të njëjtën shumë në GBP [e cila ishte gjendje në fundit të vitit 2010 e përbënte pakësim të vitit 2011], duke rezultuar në një vlerë të nënvlerësuar të zërit Pakësime/Shtesa/Likuiditeti.

<sup>42</sup> Për referencë, paragrafët 30.23, 31.18, 32.19 dhe 32.9 në vendimin objekt ankimi.

21.3. Për sa i përket pretendimit tjetër të subjektit për gabime në grupimin e vlerave dhe aplikimin e kursit të këmbimit, nga verifikimi i kryer nga Kolegji rezulton se ai qëndron. Nga mënyra e përlllogaritjes së këtij zëri dhe ekuivalentimi i zërave në monedhë të huaj konstatohet se në këtë rast subjekti ka pasur një disfavor me vlerë rreth 25.000 lekë. Megjithatë, Kolegji vëren se një konvertim mund të jetë favorizues për subjektin në rastin e një pakësimi të një likuiditeti në GBP, në vitin 2011, por rrjedhimisht mund të jetë në disfavor të subjektit në rastin e shtimit të likuiditeteve, në vitin paraardhës. Në këtë mënyrë, trupi gjykues potencon se saktësia e një analize financiare të një periudhe të caktuar kërkon analizë për të gjithë zërat dhe jo duke selektuar vetëm zëra të veçantë të saj. Në përmbledhje, pa përsëritur sa është konkluduar më sipër, ndonëse parimisht pretendimi i subjektit për këtë zë shpenzimesh qëndron, në thelb ky konstatim nuk pasqyron asnjë ndryshim në balancën financiare negative të konstatuar në Komision apo në vlerësimin përfundimtar të kryer në Kolegji, për këtë konkluzion në funksion të zgjidhjes së çështjes.

## 22. *Shkaqet e ankimit që lidhen me analizën financiare për vitin 2011*

22.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, sipas të cilit dokumenti i lëshuar nga {\*\*\*} [{\*\*\*}], në gjuhën angleze nuk provon mbulimin e shpenzimeve të personit të lidhur [vajzës së saj G. D.] nga shoqata për pjesëmarrjen. Subjekti i rivlerësimit pretendon se janë bërë të gjitha përpjekjet për të siguruar dokumente që vërtetojnë se shpenzimet e pjesëmarrjes së vajzës së saj në konferencat e organizuara nga kjo shoqatë, të cilat janë përballuar pjesërisht nga kjo e fundit, por nuk është marrë konfirmimi. Si provë të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur një e-mail mes vajzës dhe një përfaqësuesi të {\*\*\*}, që, sipas saj, provon faktin se është në kushtet e pamundësisë për paraqitjen e dokumentacionit parashikuar në neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij e-mail-i të datës 26.09.2020, bashkëngjitur ankimit, personi i lidhur [vajza e subjektit] kërkon konfirmim të pagesave, që, sipas saj, janë kryer nga shoqata {\*\*\*}, për pjesëmarrjen e saj në mbledhjet ndërkombëtare të këshillit në Poznan, Algarve dhe Koln. Në procesin e hetimit administrativ, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mbështetur pretendimin e saj për mbulimin e shpenzimeve të vajzës [në Poznan Poloni] nga data 26.03.2011-30.03.2011, me një letër rekomandimi që mban datën 09.02.2014<sup>43</sup>.

22.2. Në analizë të akteve në fashikull dhe pretendimeve të subjektit, trupi gjykues sjell në vëmendje se konkluzioni i Komisionit, për të mos i konsideruar shpenzimet në fjalë në ngarkim të shoqatës, është i bazuar. Nga ana tjetër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se mbulimi i shpenzimeve është marrë përsipër nga shoqata mbeti deklarativ e i paprovuar, sikurse mbeti i paprovuar edhe pretendimi për pamundësi objektive për marrjen e dokumenteve nga shoqata {\*\*\*}, që provojnë sponsorizimin e pjesëmarrjes së personit të lidhur. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mban në konsideratë faktin që subjekti nuk ka provuar pamundësinë objektive për të marrë konfirmimin për shpenzimet e mbuluara nga të tretët<sup>44</sup>. Subjekti nuk ka kryer asnjë

<sup>43</sup> Letra rezulton e nënshkruar nga znj. A. D., referuar si Presidentja e {\*\*\*}.

<sup>44</sup> Neni 32, pika 2 përcakton që: “[2.] Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull

veprim si pasojë e të cilit të konstatohej pamundësia objektive për disponimin e konfirmimit nga shoqata. Rekomandimi i sjellë në procesin e hetimit administrativ nuk referon në asnjë formë pamundësi nxjerrje dokumentacioni apo mungesë disponimi të akteve, sikurse as nuk përmban asnjë referencë për mbulim të shpenzimeve. Ky akt vetëm konfirmon angazhimin e vajzës së subjektit si zëvendëspresidente të shoqatës për degën në Shqipëri për periudhën kohore 2011-2013 dhe vlerëson pozitivisht kontributin e saj [të vajzës] në forcimin e kulturës demokratike dhe promovimin e projekteve të shoqatës në Shqipëri, duke organizuar studentët e drejtësisë. Më fjalë të tjera, rekomandimi konfirmon angazhimin e personit të lidhur për llogari të shoqatës jo fitimprurëse në Shqipëri. Asgjë në rekomandim nuk përmban indicie të asnjë lloji për sponsorizim aktivitetesh, përgjithësisht apo veçanërisht, të atyre objekt analize në këtë pjesë të shkakut të ankimit. Njëkohësisht, asgjë në përmbajtjen e shkresës nuk pasqyron as edhe indirekt ndonjë të dhënë që mund të argumentohet si e dhënë me natyrë financiare.

**22.3.** Duke vijuar, për sa i përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për pamundësi të mbledhjes së dokumentacionit mbështetës për të provuar mbulimin e shpenzimeve nga shoqata {\*\*\*}, trupi gjykues i Kolegjit vëren se e-mail-i i dërguar nga vajza e subjektit, në *shtator 2020*, që nënkupton një moment në kohë *pasi* subjekti ishte njohur me vendimin e Komisionit dhe përpara se të përcillte ankimin e saj [regjistruar në Komision më 06.10.2020], nuk mund të argumentohet si provë e pamundësisë objektive për të marrë dokumentacionin mbështetës të kërkuar si kusht nga ligji, për disa arsye. *Së pari*, kjo kërkesë për informacion dërgohet për herë të parë, pasi është marrë vendimi i Komisionit, ndërkohë që parimisht subjektet pritet të provojnë pretendimet *gjatë* procesit dhe në zbatim të barrës së provës e jo *pas* tij. *Së dyti*, kërkesa në vetvete, pa asnjë indicie për përgjigje apo arsyet e mungesës së saj, pa indicie nëse i drejtohet një personi/personave përfaqësues të duhur të kontaktit, nuk plotëson kriteret e vendosura nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Fakti i dërgimit të një e-mail-i, një komunikim njëkahësh i kryer në fazën e ankimit, përpos i vonuar, është i pamjaftueshëm në vetvete që të përbëjë provë se dokumenti është zhdukur, ka humbur apo nuk disponohet pa fajin e personit të lidhur. *Së treti*, dhe në drejtim të parimeve të gjykimit, ky akt dështon të kapërcejë testin e pranueshmërisë në ankim të akteve të reja pa fajin e subjektit të rivlerësimit<sup>45</sup>, në kushtet kur subjekti logjikisht i kishte të gjitha mundësitë të bënte përpjekje për të provuar këto pretendime përpara dhe gjatë procesit të hetimit administrativ. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit se gjendet në kushtet e pamundësisë për paraqitjen e dokumentacionit, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton i pabazuar në prova dhe ligj.

**22.4.** Një pretendim tjetër për analizën e vitit 2011 lidhet me udhëtimin e personit të lidhur me subjektin [djalin] jashtë Shqipërisë për disa ditë në qershor-korrik. Subjekti i rivlerësimit e konsideron të gabuar konkluzionin e Komisionit se [ajo] nuk provoi me dokumentacion mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit në fjalë, në vlerën 175 euro, nga klubi i futbollit. Sipas subjektit, djali ka qenë i federuar [nga klubi i futbollit “{\*\*\*}”] dhe në turne sportive të organizuara nga klubi, shpenzimet mbulohen nga donatorët dhe ekipi. Bashkëlidhur ankimit,

---

*zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor [...].*

<sup>45</sup> *Sipas nenit 47 të ligjit nr. 49/2012: “[...] Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.*

për të provuar këtë pretendim, subjekti ka përcjellë një deklaratë noteriale<sup>46</sup> të lëshuar pas vendimit të Komisionit, ku deklaruesi shprehet se shpenzimet e atij udhëtimit janë sponsorizuar nga presidenti i FK {\*\*\*} dhe donatorët {\*\*\*} dhe {\*\*\*}.

22.5. Nga aktet në fashikull, lidhur me këtë shkak ankimi, rezulton se subjekti ka depozituar aktet që vijojnë: (i) një vërtetim [pa datë dhe numër protokoll] nga z. I. S., në cilësinë e drejtorit të klubit të futbollit “{\*\*\*}”; dhe (ii) “Leje Kalimi”, datë 04.04.2013, e nënshkruar nga i njëjti individ, z. I. S., në këtë rast në cilësinë e administratorit të klubit të futbollit “{\*\*\*}”. Në të parin, letërshkruesi deklaron se djali i subjektit [...] *ka qenë futbollist i federuar me ekipet U 17 të klubit të futbollit “{\*\*\*}” dhe [...] pjesëtar i ekipit “{\*\*\*}” në turet futbollistike të zhvilluara në Strugë [...] në datat 28 qershor deri në 2 korrik 2010 dhe në Ascoli [Itali] në datat 30 qershor deri në 4 korrik 2011 të organizuara nga klubi i futbollit “{\*\*\*}”*. Në shkresën tjetër, konfirmohet se djali i subjektit *ka qenë futbollist i moshave të ndryshme të këtij klubi, ka marrë pjesë në ligën amatore të Federatës Shqiptare të Futbollit dhe nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj klubit të futbollit “{\*\*\*}”*. Më tej, bashkëlidhur ankimit, siç referohet më sipër, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale, datë 29.09.2020, të deklaruesit [I. B.], që mbështet pretendimin e subjektit se shpenzimet e udhëtimit në Itali, nga data 30 qershor 2011 deri më 4 korrik 2011, nga personi i lidhur [djali], nuk janë shoqëruar me shpenzime prej saj.

22.6. Nga analiza e akteve në fashikull dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren disa aspekte, të cilat e bëjnë vlerën provuese të tyre të papërfillshme. *Së pari*, dokumentacioni i sipërcituar, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit, konfirmon vetëm pjesëmarrjen e djalit të subjektit në aktivitetin e zhvilluar jashtë Shqipërisë dhe vetëm si pjesë e ligës *amatore*. Duke abstraguuar nga mungesa e datës në njërin nga shkresat, asgjë në përmbajtjen e dy akteve të nënshkruara nga drejtori futbollit/administratori i klubit të futbollit “{\*\*\*}” [z. I. S.] nuk konfirmon pretendimin e subjektit për mbulimin e shpenzimeve nga organizatorët. Për pasojë, pretendimi i subjektit mbeti deklarativ. *Së dyti*, nga këto dy akte rezultojnë fakte pa asnjë relevancë në procesin e rivlerësimit apo të cilat nuk kanë qenë objekt kontestimi, ndërkohë që referenca e vetme në detyrime financiare ka kah të kundërt – konfirmohet që edhe ndonjë detyrim që mund të ketë ekzistuar mes klubit të futbollit dhe personit të lidhur është shlyer nga ky i fundit.

22.7. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se deklarata noteriale hartuar në shtator 2020, pas vendimit të Komisionit, përbën një provë të re në ankim, e cila jo vetëm nuk përmbush kriteret e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 për provat e reja, por paraqitet me vlerë provuese të kufizuar edhe për shkak të momentit kur është hartuar dhe formës dhe cilësisë së deklaruesit, nën dritën e kërkesave të nenit 49, pika 4<sup>47</sup> e ligjit nr. 84/2016. Konkretisht, nuk ka asnjë të dhënë që të provojë pamundësinë e subjektit të rivlerësimit, pa faj të saj, për ta paraqitur këtë provë gjatë hetimit. Po ashtu, në kushtet që është hartuar në procesin e rivlerësimit edhe nga përmbajtja rezulton të jetë përpjekje për të provuar një fakt në mbështetje të situatës faktike të mungesës

<sup>46</sup> Deklarata me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} ko.l, datë 29.09.2020. e z. I. B., i cili deklarohet si ish-trajneri.

<sup>47</sup> “[4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.

së burimeve të subjektit për vitin konkret e referon mbështetje financiare të paprovuar me asnjë dokumentacion justifikues ligjor (mandatpagesë, bankare) nga një person që jo domosdoshmërisht ka përgjegjësinë ligjore të vërtetojë fakte me natyrë financiare, të një kohe të shkuar. Subjekti nuk kishte ndonjë pengesë të paraqiste dokumentacionin para dhënies së vendimit të Komisionit. Për gjithë sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi të drejtë qëndrimin e Komisionit për llogaritjen e këtij shpenzimi në ngarkim të subjektit dhe personave të lidhur.

**22.8.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka llogaritur gabimisht si shpenzim të vitit 2011, vlerën e biletës së udhëtimit të kryer nga personi i lidhur [vajza, A. D.] në datën 16.01.2011. Kjo biletë është paguar në datën 07.10.2010. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se pretendimi i subjektit për datën e pagesës së biletës është i drejtë. Paga prej 205,2 GBP për {\*\*\*} është kryer *online* në datën 07.10.2010, me destinacionin Londër-Tiranë-Londër dhe datat përkatëse, nisje në dhjetor 2010 dhe kthim në janar 2011. Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, vlera e kësaj bilete është ndarë në mënyrë të barabartë, në vitet 2010 dhe 2011, përkatësisht 102,6 GBP ose rreth 123 euro në vitin 2010 dhe po të njëjtën shumë në vitin 2011. Në kushtet kur pagesa nuk rezulton të jetë kryer në dy vite, trupi gjykues i Kolegjit e korrigjoi, përkatësisht, këtë zë në analizën financiare të kryer në Kolegj, duke pakësuar shpenzimet e udhëtimit në vitin 2011 me 102,6 GBP dhe përlllogaritur ato në vitin 2010, kur janë kryer.

**22.9.** Subjekti i rivlerësimit kërkon në ankim që shpenzimet e qëndrimit të personit të lidhur, [vajzës së saj, A. D.], në Bolzano, Itali, në periudhën kohore 15.12.2011- 01.01.2012, të llogaritet si pjesë e shpenzimeve të tjera të jetesës, përlllogaritur gjatë qëndrimit të saj në Britaninë e Madhe. Komisioni rezulton të ketë pranuar pretendimin e subjektit se ky qëndrim është mbuluar financiarisht nga një i afërm i vajzës dhe ka llogaritur në analizën financiare vetëm shpenzime qëndrimi në vlerën 5 euro/dita. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Në kushtet kur tashmë Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar të cilës i është referuar edhe Komisioni në vendimin e tij<sup>48</sup>, vlera prej 5 eurosh në ditë përlllogaritur për këtë qëndrim përbën një shpenzim bazik ditor për një udhëtim turistik në fund të vitit dhe, si i tillë, ky pretendim i subjektit nuk qëndron.

**22.10.** Sikurse konstatohet në vendim, Komisioni nuk ka përlllogaritur shpenzime akomodimi për vajzën e subjektit për këtë udhëtim, pasi ka marrë në konsideratë një deklaratë noteriale të një të afërmi, i cili shprehet se ka mbuluar shpenzimet e akomodimit të personit të lidhur në Bolzano, Itali. Vlera prej 5 euro/ditë, përlllogaritur për një individ madhor për harkun 24 orësh, është përcaktuar nga jurisprudenca e Kolegjit dhe përdorur si një qasje tejet garantiste që merr në konsideratë vetëm shpenzimet bazike, në gjithë çështjet. Përpos këtij fakti, duke marrë në konsideratë rrethanat konkrete të këtij udhëtimi turistik – kryer në një periudhë festive dimërore

---

<sup>48</sup> *Shih pikën 30.9 dhe 30.10 të vendimit të Komisionit ku arsyetohet se: “[...] Lidhur me shpenzimet e qëndrimit të xhaxhai [...], në Bolzano, për udhëtimin e personit të lidhur A. D. për datat 15.12.2011 – 01.01.2012, subjekti paraqiti deklaratë noteriale në formën e kërkuar nga ligji nga xhaxhai S. D. për mbulimin e shpenzimeve prej tij. Trupi gjykues, pasi i administroi shpjegimet e subjektit, si dhe vlerësoi provat e paraqitura, vendosi të konsiderojë të provuar mbulimin e shpenzimeve nga xhaxhai dhe llogariti në analizën financiare për këtë udhëtim vetëm shpenzime qëndrimi në vlerën 5 euro/ditë, bazuar në metodologjinë sipas vendimit nr. 11/2019(JR), datë 22.05.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”.*

në një zonë të njohur për turizmin dimëror, siç është Bolzano – për të cilin subjekti kërkon të mos përlloraget asnjë shpenzim, vlera bazike prej 5 eurosh në 24 orë është përlloragitur në qasje shumë të favorshme për subjektin, sidomos nëse mbahet në konsideratë fakti që ndryshe nga sa ka përcaktuar Kolegji në jurisprudencën e tij<sup>49</sup>, Komisioni nuk ka administruar prova të rezidencës së deklaruesit në periudhën kohore në fjalë në Itali apo të qëndrimit të tij atje përpara vitit 2014, ndërkohë që periudha në analizë daton në vitin 2011. Dokumentacioni në fashikull, mbi bazën e të cilit Komisioni ka pranuar pretendimet për mbulim shpenzimesh nga pritësi ndër vite të subjektit dhe personave të lidhur, bazuar në një deklaratë noteriale të gushtit 2019, datojnë nga viti 2014<sup>50</sup>. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit çmon se shpenzimet e jetesës të përlloragitura nga Komisioni, për vajzën e subjektit A. D., përfshijnë jetesën e saj në Mbretërinë e Bashkuar. Këto shpenzime janë llogaritur në vlera minimale jetese dhe, përpos të tjerash, janë bazuar në deklaratimet e subjektit në përgjigje të pyetësorëve.

**22.11.** Në përmbyllje të llogaritjes së vlerave të shpenzimeve të udhëtimit jashtë Shqipërisë, trupi gjykues konstaton se për dy udhëtime, përkatësisht në Larisa/Greqi (familjarisht, 11 ditë qëndrimi) dhe Londër/Britani e Madhe (dy persona – 7 ditë qëndrimi dhe 1 person – 11 ditë qëndrimi), Komisioni ka pranuar deklaratimin e subjektit për qëndrim te të afërm rezidentë në këto vende, pa administruar dokumentacion që provon vendndodhjen e pritësve në vendet ku subjekti dhe personat e lidhur kanë udhëtuar. Për të gjitha këto arsye, rezulton që vlera e përlloragitur si shpenzim minimal ditor për personin e lidhur është e drejtë dhe që Komisioni ka zgjedhur një qasje tejet favorizuese ndaj subjektit edhe për këto shpenzime.

**22.12.** Në një argument të ngjashëm me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit e konsideron të padrejtë përlloragitjen e shpenzimeve të biletave të udhëtimit të personit të lidhur [vajzës/A. D.]. Sipas subjektit, biletat e udhëtimit ajror në drejtim të Britanisë së Madhe duhet të konsiderohen të përfshira në shpenzimet jetike, të cilat, sipas saj, përfshijnë shpenzimet e transportit (rrugor, ajror apo detar). Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar edhe këtë pretendim të subjektit. Në kushtet kur shpenzimet jetike të përlloragitura sipas standardit të INSTAT, që përfshin edhe fashat e shoqërisë me të ardhura shumë më modeste sesa magistratët dhe, për pasojë, përbën përlloragitje shpenzimesh minimale, përfshirë edhe nivelin e varfërisë, pretendimi i subjektit se këto shpenzime bazike përfshijnë edhe udhëtimet ajrore me {\*\*\*} duket alogjik. Nga një analizë e thjeshtë e parimeve mbi të cilat INSTAT kryen vlerësimet zyrtare të përdorura nga organet e rivlerësimit, ndër të tjerë, vlera e shpenzimeve, që përlloragitet mbi një mesatare të përgjithshme që përfshin edhe nivelin e varfërisë, bazuar në shpenzimet e përditshme jetike të qëndrimit dhe jetesës, si dhe pagat mesatare mujore, përbën vlerësimin dysHEME, nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore. Për ilustrim, vlen të përmendet që sipas standardit të INSTAT-it për vitin 2011, shpenzimet për pesë persona përlloragiten për gjithë vitin në vlerën 546.480 lekë ose 109.296 lekë për person. Në vijim, edhe të sa është arsyetuar gjerësisht më sipër [ndër të tjerë në paragrafin 20.3], nuk mund të argumentohet se pjesë integrale e shpenzimeve për person, sipas INSTAT-it për gjithë

---

<sup>49</sup> Shih vendimin e Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit E. Islamaj (JR) nr. 11/2019, vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit D. Peka (JR) nr. 27/2020, ndër të tjera.

<sup>50</sup> Deklarata noteriale e z. S. D., datë 08.08.2019. Bashkëngjitur, deklaruesi ka përcjellë kopje të pasaportës shqiptare me datë lëshimi vitin 2010, pasaportë italiane të lëshuar në 10 korrik 2014, si dhe kartë identiteti ku referohet Komuna e Bolzanos me datë lëshimi 20 mars 2014.

vitin duhet të përlllogaritet edhe transporti ajror. Konkretisht, pasi vlera për person në vit sipas INSTAT-it, sipas kursit të këmbimit të kohës, është ekuivalent me 790 euro ose 666 GBP<sup>51</sup>, ndërsa biletat janë pjesë e konsiderueshme e kësaj vlere. Për këto arsye, ky pretendim i subjektit është i pabazuar.

**22.13.** Trupi gjykues i Kolegjit thekson se pavarësisht nga gabimet në referimin e deklaratave të subjektit të rivlerësimit, mbi bazën e të cilave është kryer analiza financiare për vitet në fjalë [2011-2014], vlen të theksohet që Komisioni e ka bazuar vlerën e balancës negative të cituar në vendimin përfundimtar në një analizë, e cila ka qenë e bazuar në pretendimet e subjektit të rivlerësimit. Për pasojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për një analizë të re duke zbritur zëra shtesë, u gjetën të pabazuara nga trupi gjykues i Kolegjit, në kushtet kur, ndër të tjera, shpenzimet e udhëtimit janë bazuar mbi pretendimet dhe aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit, ndërsa shpenzimet e jetesës në Shqipëri dhe në Mbretërinë e Bashkuar – për personat e lidhur me subjektin gjatë studimeve atje – përlllogariten sipas standardeve minimale jetike dhe vlerave të dokumentuara nga shkollat.

**22.14.** Në përfundim, pas rillogaritjes së kryer në Kolegj, duke korrigjuar vetëm zërat për të cilat pretendimet e subjektit qëndrojnë, balanca negative për vitin 2011 do të ulej nga (-) 393.760 lekë që ishte në analizën e Komisionit në (-) 351.713 lekë, përsëri subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

## **23. Analiza financiare për vitin 2012**

**23.1.** Subjekti i rivlerësimit e konsideron të padrejtë konkluzionin e Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur pamjaftueshmëri financiare për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzimet e tjera familjare, duke rezultuar me një bilanc negativ në vlerën (-) 674.543 lekë. Përpos aspekteve të tjera të shtjelluara më sipër në këtë arsyetim, të cilat lidhen me shkaqe ankimi të cilat gjejnë zbatim për të katër vitet e analizës, në vijim shtjellohet analiza e Kolegjit për shkaqe ankimi që lidhen me shpenzime specifike të vitit 2012.

**23.2.** Subjekti konteston llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit familjar në Palma de Majorka (Spanjë), në vlerën 2.250 euro, në gusht 2012, meqenëse ajo ka paraqitur si dokumentacion provues një faturë dhe një kupon tatimor që mban datën 01.08.2012, lëshuar nga agjencia turistike “{\*\*\*}”, sipas të cilëve dokumentohet pagesa prej 1.800 eurosh. Sipas saj, nuk qëndron konkluzioni i Komisionit se kjo faturë nuk provon destinacionin e shërbimit ndaj subjektit të rivlerësimit, sipas subjektit, ruajta e një dokumenti të 7 (shtatë) viteve më parë, vërteton faktin se kjo faturë i përket subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur. Për të provuar këtë pretendim, subjekti ka paraqitur bashkëlidhur ankimit dhe kërkoi të administrohej si provë edhe një deklaratë noteriale të lëshuar më datë 05.10.2020 nga një individ [znj. E. Sh.], e cila referohet si ish-administratore e agjencisë turistike në fjalë.

---

<sup>51</sup> [https://www.bankofalbania.org/Markets/Official\\_exchange\\_rate/Exchange\\_rate\\_archive/](https://www.bankofalbania.org/Markets/Official_exchange_rate/Exchange_rate_archive/)



23.3. Nga analiza e dokumentacionit të administruar për këtë qëllim nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në *faturën e thjeshtë tatimore*, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit që mban datën 01.08.2012, nuk specifikohen personin/at të cilëve u ofrohet ky shërbim sikurse edhe nuk është e vëlosur nga subjekti tregtar që ka lëshuar faturën. Të dy këto të dhëna janë elementë të parashikuar si pjesë përbërëse e faturave tatimore të thjeshta, sipas nenit 36, pika 1/1 e ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar<sup>52</sup> e paraqesin rëndësi në procesin e rivlerësimit për të vendosur lidhje mes sa pretendon subjekti e vlerës së faturës. Në këto kushte, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për mos marrjen në konsideratë të këtij akti për të provuar shpenzimet familjare. Në të njëjtën linjë logjike, pretendimi i subjektit për të përlllogaritur shpenzimin, sipas një fature tjetër për analogji, është i pabazuar për sa kohë edhe faturës tjetër i mungojnë elementët thelbësorë të formës që kërkon ligji për vlefshmërinë – siç janë përfituesi i shërbimit dhe vula e personit juridik.

23.4. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen pa vlerë provuese edhe deklaratën noteriale<sup>53</sup> të datës 05.10.2020, të një individi që prezantohet si ish-administratore e agjencisë turistike, me të cilën pretendohet të jetë kryer udhëtimi. Ky akt kërkon të vërtetojë ngjarje apo rrethana të ndodhura vite më parë, ndërkohë që subjekti nuk ka paraqitur ndonjë provë apo pretendim se ka qenë në pamundësi ta paraqiste këtë akt në Komision në mënyrë që të plotësoheshin kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Për rrjedhojë, pretendimi i mësipërm i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në prova dhe ligj.

23.5. Subjekti i rivlerësimit kundërshton llogaritjen e shpenzimeve të transportit në udhëtimin e kryer në Korfuz/Greqi në datat 29.04.2012-30.04.201, pasi shpenzimet janë përballuar nga pronari i automjetit, z. V. Q.. Referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit<sup>54</sup>, subjekti i rivlerësimit kërkon të mos llogaritet si shpenzim udhëtimi shuma 214 euro. Bashkëlidhur ankimit, subjekti ka përcjellë deklaratën noteriale, datë 02.10.2020, të z. V. Q.. Në të njëjtën linjë arsyetimi, subjekti i rivlerësimit e konsideron të gabuar llogaritjen e shpenzimeve të transportit për udhëtimet në Kosovë të bashkëshortit dhe të vajzave, përkatësisht në korrik dhe shtator 2012, respektivisht në shumat 39 euro dhe 50 euro, pasi ata kanë qenë pasagjerë në këto udhëtime.

23.6. Nga shqyrtimi i akteve të administruara në fashikullin e hetimit administrativ, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për të mbështetur pretendimin se ajo dhe personat e lidhur kanë qenë pasagjerë në këto udhëtime jashtë territorit të Shqipërisë. Në këto kushte, vlerësimi dhe përlllogaritja e kryer nga Komisioni për këto udhëtime rezulton i drejtë. Për sa i përket udhëtimit në prill të të njëjtit vit në Greqi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se deklarata noteriale e sjellë nga subjekti i

---

<sup>52</sup> Sipas kësaj dispozite: “Në fund të faturës shënohet blerësi me emër, mbiemër, nënshkrim, transportuesi me emër, mbiemër, nënshkrim dhe shitësi me emër, mbiemër, nënshkrim dhe vulë”.

<sup>53</sup> Deklaruesja, E. Sh., shprehet se ajo ka lëshuar “[...] faturën e thjeshtë tatimore, bashkëngjitur me kupon tatimor nr. {\*\*\*} e datës 01.08.2012 dhe me nr. serial {\*\*\*} [...] në emër të G. S. D. dhe familjarëve të saj (e përbërë nga 5 persona)”. Gabimet gramatikore janë të deklarueses.

<sup>54</sup> Vendimi që i përket subjektit të rivlerësimit E. Islamaj (JR) nr.11/2019, në të cilin Kolegji ka vlerësuar se “[...] kur subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur me të kanë udhëtuar me automjet të cilin nuk e kanë në pronësi/përdorim dhe provojnë se kanë qenë pasagjerë, shpenzimet e transportit nuk do të përlllogariten [...]”.

rivlerësimit bashkëlidhur ankimit<sup>55</sup>, për të provuar se shpenzimet janë përballuar nga pronari i automjetit, ka një fuqi të kufizuar provuese edhe nëse do vërtetësia e saj do të merrej e mirëqenë. Në kushtet kur deklarata është hartuar muaj pas shpalljes së vendimit të Komisionit, si dhe 8 (tetë) vjet pas kryerjes së këtij udhëtimi, pa asnjë indicie të pamundësisë së subjektit se gjendet në kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 për provat e reja në ankim, ndërsa përpqet të dëshmojë ngjarje të mëparshme, sikurse edhe pretendime të tjera të analizuara më sipër, edhe ky akt paraqitet si një përpjekje e subjektit për të minimizuar shpenzimet e përgjysmuara në vendimin përfundimtar të Komisionit edhe më tej krahasuar me rezultatet e hetimit. Deklarimi i subjektit se ajo dhe personat e lidhur kanë udhëtuar me automjete që nuk ka qenë në pronësi apo përdorim të tyre është i pamjaftueshëm për të zbritur shpenzimet në tërësi në kushtet kur subjekti nuk ka sjellë dokumentacion provues për këtë pretendim. Për rrjedhojë, llogaritja e shpenzimeve të udhëtimeve të sipërcituara të subjektit dhe familjarëve të saj nga Komisioni vlerësohet e drejtë nga Kolegji.

23.7. Trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të drejtë pretendimin e subjektit se përlllogaritja e një pjese të vlerës së biletës së udhëtimit të kryer nga vajza A. D. në datën 25.03.2013, si shpenzim i vitit 2012<sup>56</sup>, është vendosur gabim nga Komisioni. Nga pagesa elektronike rezulton se kjo biletë është paguar plotësisht në datën 09.02.2013, ndërsa ndarja e vlerës në mënyrë të barabartë në dy vite nga Komisioni është e pabazuar, në kushtet kur bileta është shlyer tërësisht në një pagesë në vitin 2013<sup>57</sup>. Për këtë arsye, në analizën financiare të kryer në Kolegji, u krye korrigjimi, duke u pakësuar shpenzimet e udhëtimit në vitin 2012 me 88,5 GBP dhe shtuar shpenzimet e udhëtimit në vitin 2013 me po të njëjtën vlerë.

23.8. Për sa i përket shpenzimeve të udhëtimit të familjes D. për vitin 2012, të cilat përpos rubrikës së dedikuar më sipër për shpenzimet e udhëtimit ato pjesërisht pasqyrohen në analizën e vitit 2011, pa përsëritur sa shtjellohet gjerësisht më sipër në paragrafin 22.11 dhe 22.12, nga rillogaritja e tyre në funksion të shkaqeve të ankimit në Kolegji, trupi gjykues konstatoi se për udhëtimet me destinacion Londër, përkatësisht 7 ditë qëndrimi për dy persona dhe 19 ditë qëndrimi për 1 person, Komisioni ka pranuar deklarinimin e subjektit për qëndrim të afërm rezident në këto vende, pa administruar dokumentacion provues të asnjë forme. Siç është arsyetuar gjerësisht më sipër në paragrafët e referuar, pranimi i pretendimeve të subjektit pa asnjë dokumentacion mbështetës është një zgjedhje favorizuese e Komisionit, që bie ndesh me ligjin<sup>58</sup> dhe me jurisprudencën e Kolegjit. Në këto kushte, ky shkak ankimi i subjektit është i pabazuar. Komisioni është treguar favorizues ndaj subjektit të rivlerësimit, ndonëse rivlerësimi i subjektit është konkluduar *një vit pasi* Kolegji kishte përcaktuar qartë dokumentacionin

---

<sup>55</sup> Nëpërmjet të cilës, deklaruesi, z. V. Q., shprehet se ka udhëtuar më datë 29.04.2012 në Greqi “nëpërmjet pikës kufitare Qafë Boti Sarandë së bashku me miqtë e mi z. S. D. dhe Nure Dreni [...] me autoveturën në pronësi timen me targa {\*\*\*} dhe nuk kanë paguar shpenzime për transportin”.

<sup>56</sup> Komisioni ka përlllogaritur përkatësisht 88,5 GBP ose rreth 106 euro në vitin 2012 dhe të njëjtën shumë në vitin 2013.

<sup>57</sup> Sipas biletës elektronike, vlera totale e paguar është 261,21 GBP dhe në rubrikën dedikuar vlerës, referohet çmimi 177 GBP.

<sup>58</sup> Sipas nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016: “[4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.

mbështetës<sup>59</sup> që duhet të sjellin subjektet që pretendojnë qëndrim pa shpenzime jashtë Shqipërisë. Në vlerësim të këtij arsytimi, nëse llogaritja e shpenzimeve të udhëtimit do të kryhej sipas këtij qëndrimi të Kolegjit, atëherë shpenzimet e akomodimit për këto udhëtime nuk do të kalkuloreshin me vlerën minimale të shpenzimeve prej 5 euro/ditë, por do të kalkuloreshin normalisht me vlerën e qëndrimit 50 euro/ditë për person. Në këtë rast, vlera e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2012 do të ishte rreth 6.163 euro apo rreth 853.171 lekë. Në kuadër të respektimit të parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit u rillogaritën vetëm vlerat sipas Komisionit dhe ato për të cilat pretendimet e subjektit të rivlerësimit qëndrojnë.

**23.9.** Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka pasqyruar gabim vlerën e likuiditeteve (*cash* dhe në bankë), pasi në pikën 31.19 të vendimit është shënuar kursime (pakësime dhe shtesa) vlera 891.218 lekë, në një kohë që referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2012, janë pakësuar nga gjendja *cash* në banesë vlera prej 800.000 lekë dhe shuma prej 890 GBP, nga llogaria bankare e vajzës (konvertuar në lekë sipas kursit të këmbimit që ka përdorur Komisioni) në vlerën 152.350 lekë. Subjekti i rivlerësimit kërkon të reflektohet si pasuri në kolonën pakësim/shtesa likuiditeti vlera 952.350 lekë.

**23.10.** Pasi analizoi deklaratën periodike vjetore përkatëse dhe aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Në deklaratën e interesave periodike vjetore 2012, në rubrikën dedikuar ndryshimeve të pasurive, subjekti ka deklaruar pakësim të gjendjes në *cash*-in e deklaruar në vite *në shumën 800.000 lekë*, ndërsa vajza e subjektit të rivlerësimit [A. D.] ka deklaruar *pakësim nga gjendja e deklaruar në vitin e kaluar në llogari [...] në H.S.B.C.bank [...] në vlerën 890 paund*. Nga llogaritjet e kryera në Kolegj rezulton se pakësimi *neto* i likuiditeteve prej (-) 891.218 lekësh, llogaritur nga Komisioni për vitin 2012, vjen nga pakësimi i gjendjes *cash* në banesë prej 800.000 lekësh, nga pakësimi i shumës prej 890 GBP nga llogaria bankare e vajzës, si edhe nga një shtesë *neto* në balancat e llogarive të tjera bankare, me vlerë totale prej 56.450 lekësh ekuivalent. Këtë shumë subjekti nuk e përmend në pretendimin e saj. Në këtë kuptim, ndryshimi i likuiditeteve në vitin 2012 nuk vjen vetëm nga pakësimi i gjendjes *cash* në banesë dhe pakësimi i llogarisë bankare të vajzës, sikurse pretendon subjekti, por edhe si rrjedhojë e ndryshimit të balancave të llogarive të tjera bankare. Për rrjedhojë, trupi gjykues konkludoi se pretendimi i subjektit për këtë shkak ankimi është i pabazuar.

**23.11.** Në përfundim, balanca negative për vitin 2012, pas rillogaritjes së kryer në Kolegj, duke korrigjuar vetëm zërat për të cilat pretendimet e subjektit qëndrojnë, do të ulej nga (-) 674.545 lekë që ishte në analizën e Komisionit në (-) 659.694 lekë. Subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, për vitin 2012.

## 24. Analiza financiare për vitin 2013

**24.1.** Subjekti i rivlerësimit e konsideron të padrejtë dhe jo objektiv konkluzionin e Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur pamjaftueshmëri financiare për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzimet e tjera

---

<sup>59</sup> Shih edhe poshtëshënimet nr. 52 dhe 66 referuar vendimit të Kolegjit nr. 11/2019, datë 22.05. 2019.

familjare, duke rezultuar me një bilanc negativ në vlerën (-) 300.309 lekë. Shkaqet e ankimit të subjektit për këtë vit, përpos atyre të shtjelluar gjerësisht më sipër, që gjejnë zbatim për të gjithë vitet me balancë negative, përfshijnë edhe pretendime që lidhen me udhëtime jashtë shtetit të kryera nga personat e lidhur, si dhe përlllogaritjen e *cash*-it të deklaruar prej saj në deklaratën periodike vjetore përkatëse. Në vijim, për të evituar përsëritjen, shtjellohet arsyetimi i Kolegjit për ato aspekte të këtyre zërave, për të cilët nuk ka arsyetim të dedikuar.

**24.2.** Subjekti i rivlerësimit e konsideron njëanshmëri nga Komisioni përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit në shumën 73 euro për personin e lidhur [bashkëshortin] në Strugë/Maqedoni e Veriut, në dhjetor 2013, meqenëse qëndrimi ka qenë disa orësh dhe janë përballuar nga një i tretë [z. I. M.]. Për të provuar këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur e kërkon të merret në cilësinë e provës një deklaratë noteriale të datës 29.09.2020, nga ky individ. Sipas kësaj deklarate, personi në fjalë shprehet se ka përballuar financiarisht shpenzimet për udhëtimin disa orësh në Strugë.

**24.3.** Trupi gjykues i Kolegjit, *së pari* sjell në vëmendje se në linjë edhe me jurisprudencën e sipër referuar e të konsoliduar, që daton nga maji 2019, udhëtimet brenda ditës përlllogariten në vlera minimale e të çmuara si tejet garantiste, pasi përfaqësojnë vlerën më të ulët të shpenzimit për ditë qëndrimi. Për sa kohë subjektet nuk provojnë që udhëtimet nuk janë shoqëruar me asnjë shpenzim, kostoja ditore e përlllogaritur nga Komisioni, edhe në këtë rast, është vlera minimale e nevojshme për një shpenzim ditor. *Së dyti*, pa përsëritur sa është arsyetuar gjerësisht më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka pasur asnjë pengesë për të paraqitur deklaratën noteriale të paraqitur bashkë me ankimin në Komision. Në kushtet kur subjekti nuk provon pamundësinë për ta paraqitur këtë akt në hetimin administrativ, nën dritën e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 që rregullon provat e reja me ankimin, kjo deklaratë nuk u pranua në shqyrtimin e kryer nga Kolegji. *Së treti*, edhe duke abstraguuar nga sa më sipër, në kushtet kur kjo deklaratë rezulton e hartuar 7 (shtatë) vjet pasi ka ndodhur udhëtimi dhe gjatë procesit të saj të rivlerësimit, ka një fuqi të kufizuar provuese në drejtim të asaj çka kërkon të vërtetojë subjekti, pasi në analizë të gjithë rrethanave paraqitet si një përpjekje e subjektit në një fazë të avancuar të procesit për të minimizuar balancën negative me gjithë mënyrat e mjetet e mundshme dhe jo si pasqyrim i sa ka ndodhur në realitet.

**24.4.** Sikurse edhe për gjithë shkaqet e tjera të ankimit, në analizë të pretendimeve të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit verifikoi hyrje-daljet jashtë territorit të shtetit shqiptar në sistemin *TIMS*. Nga këto të dhëna zyrtare rezulton që qëndrimi i personit të lidhur jashtë Shqipërisë ka qenë 2 orë [dalja në orën 11:27 dhe hyrja në orën 13:33]. Nën dritën e kësaj të dhëne, në analizën e kryer në Kolegji në përlllogaritjen e këtij shpenzimi, trupi gjykues e reduktoi koston ditore të qëndrimit me 25 euro [që konsiston në gjysmën e koston së një dite të plotë qëndrimi të përlllogaritur nga Komisioni].

**24.5.** Subjekti i rivlerësimit konteston përlllogaritjen e vlerës 280 euro si shpenzime udhëtimi të personit të lidhur [vajzës] nga Londra në Francë në janar 2013. Ky udhëtim është kryer me tren [\*\*\*] dhe jo me avion, argumenton subjekti. Në mbështetje të pretendimit për një vlerë më të ulët, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur për analogji një biletë udhëtimi të datës 18.09.2018, paguar *online* për udhëtime me {\*\*\*} të vajzave të saj, me të njëjtin destinacion,

për dy persona, kthyesë, në shumën totale 112 paund. Gjithashtu, ky shpenzim, sipas subjektit të rivlerësimit, është përballuar nga vetë vajza e saj, pasi është kryer gjatë periudhës së studimit/qëndrimit të saj në Londër.

24.6. Trupi gjykues verën se edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Nga aktet në fashikujt e Komisionit rezulton se subjekti nuk ka specifikuar nëse ky udhëtim është kryer me avion apo me tren<sup>60</sup>. Pretendimi për udhëtim me tren rezulton i paraqitur në ankim për herë të parë. Ndërkohë, nga një kontroll në burime të hapura/websitet e biletave<sup>61</sup> të trenit nga Londra në Paris, rezulton se biletat e {\*\*\*} kthyesë aktualisht janë në vlerën mbi 150 GBP. Për këto arsye, në kushtet kur mbetet e paprovuar me dokumentacion çmimi i paguar apo mënyra e udhëtimit dhe nuk mund të kryhet përlllogaritja mbi bazën e biletave të paguara vite më pas apo në padijeni të ekzistencës apo jo të rrethanave favorizuese financiare për secilin prej udhëtimeve që kërkohet të vendosen në analogji, pretendimi i subjektit mbetet në nivel deklarativ dhe i pabazuar në prova. Për rrjedhojë, në përlllogaritjen e kryer në Kolegj, pretendimi i subjektit nuk u mor në konsideratë.

24.7. Për një udhëtim të vajzës në Gjermani, në të njëjtin vit, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka llogaritur gabim shpenzimet duke i shtuar një ditë qëndrimi. Pasi verifikoi të dhënat zyrtare nga sistemi *TIMS*, trupi gjykues konstatoi se ky pretendim i subjektit qëndron. Rezulton se personi i lidhur [vajza, G. D.] ka dalë jashtë kufirit shqiptar në datën 08.04.2013, në orën 3:42 të mëngjesit dhe ka hyrë në datën 17.04. 2013, në orën 23:56. Me fjalë të tjera, qëndrimi jashtë Shqipërisë ka zgjatur për nëntë (9) ditë. Komisioni, sipas formulës matematikore të përdorur, nga diferenca midis datës së hyrjes me datën e daljes, e ka llogaritur 9.8 ditë [për shkak të nisjes në orët e para të mëngjesit dhe mbërritjes në orët e vona të mbrëmjes], e cila e rrumbullakosur sipas formulës së Komisionit është 10 ditë qëndrimi. Nga sa më sipër, trupi gjykues, duke vlerësuar të drejtë pretendimin e subjektit, e korrigjoi analizën e Komisionit duke e pakësuar me koston e një dite qëndrimi apo 50 euro.

24.8. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar/mbuluar shpenzimet në vitin 2013 dhe që balanca negative në vlerën 300.309 lekë e konstatuar nga Komisioni për këtë vit ka ardhur si pasojë e mospërfshirjes së vlerës së saktë të pakësimit të gjendjes së *cash*-it. Sipas saj, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* shumën 900.000 lekë, ndërsa Komisioni në analizën financiare në pikën 32.20 të vendimit në rubrikën “Kursime (Pakësim/shtesa likuiditet) ka vendosur vlerën prej 648.449 lekësh. Sipas subjektit, diferenca e llogaritur më pak nga sa është deklaruar si kursim rezulton në shumën prej 251.551 lekësh, sipas një veprimi të thjeshtë matematikor (900.000 - 648.449).

24.9. Pasi verifikoi aktet në fashikull dhe pretendimin e subjektit, trupi gjykues konstaton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar. Pakësimi *neto* i likuiditeteve llogaritur

---

<sup>60</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “[...] vajza A. D. nga data 24.01.2013 deri më datë 26.01.2013 ka udhëtuar [...] në Paris, ka qëndruar dhe është akomoduar në Hotel {\*\*\*}, Paris Francë”.

<sup>61</sup> Ndër të tjera, në <https://booking.eurostar.com/uk-en/eurostar-sales?bookingType=standard&origin=7015400&destination=8727100> ose në <https://www.raileurope.com/en/destinations/london-paris-train>

nga Komisioni në vitin 2013 prej (-) 648.449 lekësh rezulton nga pakësimi i gjendjes *cash* në banesë prej 900.000 lekësh dhe një shtesë *neto* në balancat e llogarive të tjera *bankare*, me vlerë 251.551 lekë ekuivalent, të cilën subjekti nuk e përmend në pretendimin e saj. Me fjalë të tjera, ndryshimi i likuiditeteve në vitin 2013, sipas përlllogaritjes së Komisionit, nuk është vetëm derivat i pakësimit të gjendjes *cash* në banesë, sikurse pretendon subjekti, por edhe nga ndryshimi i balancave të llogarive të tjera *bankare*.

**24.10.** Në analizë të sa më sipër konstatuar, në përfundim të analizës financiare për vitin 2013, pas rillogaritjes së kryer në Kolegj, duke korrigjuar vetëm zërat për të cilat pretendimet e subjektit qëndrojnë, trupi gjykues konstaton që balanca negative për vitin 2013 do të përkeqësohej në (-) 304.695 lekë nga (-) 300.309 lekë, që ishte në analizën e vendimit të Komisionit. Nën dritën e mospërkeqësimit të situatës së subjektit, vlera negative e konstatuar nga Komisioni konfirmohet. Si rrjedhojë, edhe për këtë vit të analizuar, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

## 25. *Analiza financiare për vitin 2014*

**25.1.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për mungesë burimesh të ligjshme për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzimet e tjera familjare, duke rezultuar me një bilanc negativ në vlerën (-) 1.417.908 lekë, për vitin 2014. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shpjegimet e saj, në raportin e hetimit administrativ datë 01.12.2019. Po ashtu, subjekti pretendon se në seancën dëgjimore të datës 03.03.2020 nuk u parashtrua gjendja *cash* e deklaruar ndër vite si problematikë. Gjendja e likuiditeteve jashtë sistemit bankar në vitin 2014, në vlerën 1.600.000 lekë, rrjedh nga shuma prej 1.900.000 lekësh, e investuar në bono thesari në Bankën e Shqipërisë dhe deklaruar prej saj në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003. Kjo shumë, sipas subjektit, është tërhequr në fund të muajit tetor të vitit 2004 dhe nuk është deklaruar në deklaratën periodike të kohës [vitin 2004], pasi *ka menduar se gjendja 0.00 lekë në bono thesari* deklaruar prej saj, nënkupton se *cash-i është në shtëpi*, meqenëse *nuk ka deklaruar shpenzime të tjera* atë vit. Mungesa e deklarimit është një pakujdesi/pasaktësi në DPV-në e vitit 2004, meqenëse *nuk është shënuar* ruajtja në *cash* e fondeve të tërhequra nga bonot e thesarit. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit potencon deklaratat e interesave private përpara fillimit të detyrës së personit të lidhur/bashkëshortit, më datë 15.11.2013. Në faqen 4 të kësaj deklarate, personi i lidhur ka deklaruar likuiditet/*cash* në banesë shumë 1.600.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ky deklarim tregon gjendjen e *cash-it* ndër vite, e cila është pakësuar deri sa është zeruar në vitin 2014.

**25.2.** Komisioni ka konkluduar se deklarimi i subjektit për përdorim të *cash-it* jashtë sistemit bankar në vlerën 1.600.000 lekë, në këtë vit, nuk mund të ndodhte, pasi në fund të vitit pararendës [dhjetor 2013] subjekti mund të dispononte vetëm 44.175 lekë *cash*. Nën dritën e vlerës provuese që kanë deklaratat periodike vjetore, sipas pikës 5, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni konkludoi se pakësimi i gjendjes së *cash-it* deklaruar në vitin 2014, si likuiditet *cash* i padeklaruar që nga viti 2004, nuk mund të merret në konsideratë.

**25.3.** Në analizë të akteve në fashikull dhe pretendimeve të subjektit për këtë shkak ankimi, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se vlerësimi i kryer nga Komisioni është i drejtë. Pretendimet

e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara. Ky konkluzion bazohet në argumentet e shtjelluara në detaj në vijim.

- a. Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim, për vitin 2003, në formularin e dedikuar likuiditeteve, subjekti ka deklaruar bonot e thesarit në vlerën 1.9 milion lekë.
- b. Në deklaratën e interesave periodike për vitin 2004, që mban datën 16 mars 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Gjendje cash 1.000.000 (një milion lekë)”*.
- c. Në deklaratën e interesave periodike për vitin 2013, që mban datën 24 mars 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Pakësim në gjendjen cash deklaruar në deklaratat e mëparshme ndër vite [...] 900.000 (nëntëqind mijë lekë)”*.
- d. Në deklaratën e interesave periodike për vitin 2014, që mban datën 24 mars 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Pakësim në gjendjen cash deklaruar në deklaratat e mëparshme ndër vite [...] 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë lekë)”*.
- e. Personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti, në momentin kur është bërë subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003 për shkak të një detyre të re të tij, në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës, që mban datën 15.11.2013, ndër të tjera, ka deklaruar: *“Cash në shumën 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë”*. Burimi i krijimi të kësaj shume mungon.<sup>62</sup>
- f. Në procesin e hetimit administrativ, përpos shpjegimeve të tejzgjata e në kapërcim të objektit të pyetjes, subjekti i rivlerësimit është shprehur se *shuma e [...] tërhequr në fund të muajit tetor të vitit 2004 [...] (1960000 lekë) është mbajtur [...] cash në banesë [...] pakësuar në vitet e mëvonshme sipas deklaratave periodike të pasurisë deri në vitin 2015 [...]*<sup>63</sup>.

**25.4.** Nga analiza e akteve të mësipërme, trupi gjykues konstaton se në periudhën kohore të ndërmjetme, nga viti 2004 e deri në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar pakësim të gjendjes së likuiditeteve, por asnjëherë ekzistencën e ndonjë sasive *cash*-i që përkon me shumën e deklaruar në nëntor 2013 nga personi i lidhur. Për herë të parë, pretendimi i gjendjes së kësaj vlere të mbajtur në shtëpi, pas tërheqjes nga banka në fund të tetorit 2004, ka dalë për herë të parë në procesin e hetimit administrativ. Deklarata para fillimit të detyrës e personit të lidhur në nëntor 2013 referon *cash*, por në kushtet kur deklaruesi nuk specifikon burimin, prezumimi i kryer nga Komisioni, për të përllogaritur mundësinë e krijimit të kësaj shume me të ardhurat e ligjshme të vitit, është i bazuar në ligj dhe në jurisprudencën e Kolegjit. Ndër të tjera, Kolegji ka arsyetuar ndër vite si vijon:

*“[85] Nga aktet në fashikull, e më konkretisht deklaratat periodike vjetore 2003-2016 dhe nga ajo vetting, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar që nga viti 2005 shtesa dhe pakësim të kësaj shume në banesë, në zbatim të detyrimeve të parashikuara më sipër, që nënkupton ose që shuma në fjalë nuk është përdorur ose shtesat dhe pakësimet e saj nuk janë deklaruar sipas ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe ligjit nr. 84/2016 – gjurmë të kësaj shume nuk gjenden as në deklaratën vetting. Për këto arsye, në konkluzion të shqyrtimit të këtij shkaku*

<sup>62</sup> Formulari i dedikuar deklarimit për herë të parë, faqja 4 e të cilit në krye specifikon: *“Deklarimi i pasurive dhe Burimi i Krijimit”*, e udhëzon se objekti i deklarimit janë: *“[...] Të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite deri në ditën e fillimit të detyrës [...] burimet e krijimit të tyre [...] të zotëruara nga zyrtari, ose në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en [...]”*.

<sup>63</sup> Në përgjigje të pyetësorit të datës 27.09.2019.

*ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk është bindës dhe, për pasojë, nuk mund të merret në konsideratë. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës<sup>64</sup>”.*

*“[19.4.vi] Përpos sa është arsyetuar më sipër, përkundër argumentit që në funksion të procesit të rivlerësimit, deklaratat periodike vjetore kanë vlerë vetëm në mungesë të provave të tjera dhe gabimet në to nuk përbëjnë objekt vlerësimi nga institucionet e rivlerësimit, mbështetja në deklaratat periodike vjetore, sidomos kur në fokus janë likuiditete jashtë sistemit bankar, nuk përbën rivlerësim mbi bazën e deklaratave të mëparshme apo zbatim të një mase disiplinore me fuqi prapavepruese. Së pari, sepse siç është shtjelluar gjerësisht më sipër, mospërputhjet në deklarimin e likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar për subjektin e rivlerësimit përfshijnë deklaratën vetting, pyetësorët dhe qëndrimin e tij në procesin gjyqësor në Kolegji. Pa përsëritur sa është arsyetuar më sipër, ndërsa deklaratimet periodike vjetore përbëjnë dokument zyrtar sipas ligjit dhe janë të vetmet referenca të ekzistencës së likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar dhe kanë vlerë prove në procesin e rivlerësimit [në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016], analiza e deklaratës vetting dhe e shpjegimeve të subjekteve në proces përkundër deklaratave periodike është esenciale në vlerësimin e krijimit të pasurive në analizë të mundësive të krijimit me burime të ligjshme [...]”<sup>65</sup>”.*

**25.5.** Në linjë me sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje se ligji nr. 9049/2003, pavarësisht nga ndryshimet ndër vite, ka pasur detyrim të qartë për subjektet deklarues, përfshirë subjektin e rivlerësimit, për të pasqyruar çdo ndryshim të gjendjes cash në çdo deklaram periodik në gjendjen që ishte në 31 dhjetor të vitit të mëparshëm. Neni 4 parashikon: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”.

**25.6.** Formulari i deklarimit<sup>66</sup> të pasurisë për vitin 2004, i miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së dhe i plotësuar nga subjekti i rivlerësimit, në faqen 3, ka përshkruar mënyrën se si duhen deklaruar interesat, duke udhëzuar zyrtarët të deklarojnë çdo ndryshim (shesë dhe pakësim) të interesave pasurorë. Pretendimet për mënyrën e deklarimit të likuiditeteve dhe pasojat që sjell mosdeklarimi i tyre janë trajtuar gjerësisht edhe në vendimet

<sup>64</sup>Vendimi i Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit Xh. Zaganjori (JR nr. 19/2019). [https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh\\_Zaganjori-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-parallel.pdf](https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh_Zaganjori-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-parallel.pdf).

<sup>65</sup>Vendimi i Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit D. Peka (JR nr. 27/2020). [https://kpa.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendimi\\_Dritan-Peka\\_i\\_anonimizuar\\_per\\_web.pdf](https://kpa.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendimi_Dritan-Peka_i_anonimizuar_per_web.pdf)

<sup>66</sup> “Të gjitha llojet e pasurive të luajtshme të regjistruara në regjistrat publikë, sendet me vlerë të veçantë 5.000 dollarë (ose i barasvlershmi i tij në lekë shqiptare), vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim, vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj, që disponon brenda dhe jashtë vendit zyrtari, bashkëshortja dhe fëmijët në moshë madhore”.



e Kolegjit. Pretendimi i subjektit, për mospasjen e eksperiencës në mënyrën e plotësimit të të dhënave në deklaratën e parë të pasurisë, nuk qëndron. Pretendime të ngjashme kanë gjetur analizë të konsoliduar në vendimet e mëparshme të Kolegjit, për sa i përket arsyeve përse nuk ka vend për të parashtruar paaftësi për të kuptuar ligjin nga magjistratët<sup>67</sup>. Në rrethanat konkrete, nuk rezulton që subjekti të ketë kryer ndonjë korrigjim të deklarimeve të saj periodike apo të ketë shpjeguar vullnetarisht, qoftë edhe pas deklaramit të parë të personit të lidhur në nëntor 2013, burimin e krijimit të *cash*-it apo mënyrën sesi janë ruajtur këto të ardhura të konsiderueshme në banesë, të cilat, sipas pretendimeve në hetimin administrativ, kanë mbetur të papërdorura në një sasi të konsiderueshme edhe nëntë (9) vjet pasi janë tërhequr, ndërkohë që nevojat familjare të subjektit prezumohet që rriteshin, sidomos nëse mbahet në konsideratë kostoja e studimeve të larta në Britaninë e Madhe të njërës prej fëmijëve.

25.7. Për të gjitha këto arsye, pretendimi i subjektit se është lënë në heshtje një shumë e konsiderueshme e *cash*-it në banesë, për shkak se nënkuptohet ekzistenca e tyre si derivat i tërheqjes, është e pakuptimtë, pasi nuk përputhet me formimin e subjektit dhe as me pretendimet për pasaktësi të paqëllimshme. Këto pretendime bien ndesh me gjuhën e qartë të përdorur nga legjislatori në ligjin nr. 9049/2003 dhe formulari i deklaramit të interesave privatë. Këto dy dokumente, përcaktojnë detyrimin e zyrtarit deklarues të deklarojë gjendjen e parave *cash* dhe burimin e tyre, pa lënë vend për mundësi nënkuptimi. Trupi gjykues çmon të theksojë se gjendja e likuiditeteve *cash* apo kursimet e shtuara kësaj gjendjeje nuk mund të provohen ndryshe në këtë proces, përveçse me deklaratat periodike, si i vetmi dokument i krijuar në kohën që pretendohet krijimi i kësaj pasurie, që mund ta provojë atë. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit për gjendjet *cash* të mbartura në vite, por të padeklaruara në deklaratat periodike, sipas detyrimeve ligjore të ligjit nr. 9049/2003, janë shfaqur për herë të parë vetëm në deklaratën e vitit 2014. Në analizë të fakteve të mësipërme, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike të viteve 2004-2014, posedimin *cash* në banesë të shumës prej 1.600.000 lekësh ose përdorimin e saj, e bën të pamundur për institucionet e rivlerësimit gjurmimin e ekzistencës së kësaj shume në vitet përkatëse. Për rrjedhojë, mbetet i paprovuar pretendimi i subjektit se ajo ka poseduar në fund të vitit 2014 një sasi likuiditeti nga bonot e thesarit të deklaruar për herë të fundit në deklaratën periodike të vitit 2003.

25.8. Në kushtet kur në asnjë nga deklaratat periodike të periudhës kohore të ndërmjetme, 2004-2016, subjekti nuk ka referuar të ardhurat nga investimi i mbyllur në bonot e thesarit në tetor 2004, si të ruajtura në *cash*, por ka deklaruar gjendje, shtesa dhe pakësime, edhe në analizën e kryer në Kolegj, sikurse edhe në Komision gjatë kontrollit të vendimit, trupi gjykues gjeti mungesë burimesh dhe konfirmon balancën negative të konstatuar nga vendimi i Komisionit.

26. Në përfundim të arsyetimit të mësipërm, pasi analizoi në detaj të gjithë shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, si dhe pasi shqyrtoi provat e administruara në këtë çështje, trupi gjykues i Kolegjit i gjen të bazuara konkluzionet e Komisionit. Bazuar në analizën e mësipërme faktike dhe ligjore, rezulton se balanca negative e përlllogaritur nga

---

<sup>67</sup> Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit me nr. 19/2019 dhe 27/2020, referuar edhe më sipër.

Komisioni, për shpenzimet dhe investimet e kryera për periudhën 2011-2014, edhe duke pranuar disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit për zëra të caktuar, mbetet thujse e njëjtë me atë të gjetur nga Komisioni. Konkretisht, duke pranuar disa nga pretendimet e subjektit, balanca për këto katër vite, në analizën e kryer nga Kolegji ulet në nivel të papërfillshëm nga (-) 2.786.521 lekë në (-) 2.734.009 lekë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

27. Në përmbledhje dhe për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 263, datë 17.06.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 263, datë 17.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Nure Dreni.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 15.03.2023, në Tiranë.

#### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi - kundër*

#### **ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi - kundër*

#### **RELATORE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për zgjidhjen e çështjes që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Nure Dreni, kundër vendimit nr. 263, datë 17.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendim i cili ka shkarkuar subjektin e rivlerësimit nga detyra e gjyqtares në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Bazuar në vlerësimin tim të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, kam votuar për ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.
3. Qëndrimi im i pakicës, në kundërshtim të arsytimit në vendimin e shumicës së trupit gjykues, do të ndalet në ato fakte dhe rrethana që meritojnë një vlerësim të ndryshëm, i cili ka qenë përcaktues për votën kundër.
4. Subjekti i rivlerësimi Nure Dreni është shkarkuar prej Komisionit, mbështetur në konkluzionet që i përkasin kriterit të vlerësimit të pasurisë, duke konkluduar se si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera, në vlerën totale prej (-) 2.786.519 lekësh, për vitet 2011-2014, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.
5. Në vlerësimin tim, problematikat e evidentuara nga Komisioni lidhur me këtë kriter, duhen vlerësuar në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, sipas parashikimit të nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Nën dritën e këtyre parimeve, nuk justifikohet dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin të rivlerësimit Nure Dreni, për sa më poshtë.
6. Siç pasqyrohet edhe nga arsyetimi i vendimit të Komisionit, situata financiare e subjektit të rivlerësimit ka konfirmuar mungesat e burimeve të tij financiare për të justifikuar shpenzimet e kryera, të evidentuara nga analiza e kryer në Komision, në vitet dhe vlerat si vijojnë.
  - Në vitin 2011, ka mungesë të burimeve të ligjshme në masën (-) 393.759 lekë.
  - Në vitin 2012, ka mungesë të burimeve të ligjshme në masën (-) 674.543 lekë.
  - Në vitin 2013, ka mungesë të burimeve të ligjshme në masën (-) 300.309 lekë.
  - Në vitin 2014, ka mungesë të burimeve të ligjshme në masën (-) 1.417.908 lekë.
7. Këto diferenca negative janë kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit, duke pretenduar se zëra të caktuar të analizës financiare janë përlogaritur në mënyrë jo të drejtë nga Komisioni. Në vijim, po trajtoj ato pretendime të subjektit të rivlerësimit, të cilat, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, i kam gjetur të drejta dhe me ndikim në rezultatin e analizës financiare për vitin përkatës.
  - a. *Lidhur me likuiditetet në cash*
8. Jam shprehur kundër qëndrimit të shumicës së trupit gjykues që ka vendosur të mos konsiderojë në analizën financiare të vitit 2014 shumën prej 1.600.000 lekësh, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si gjendje kursimesh në *cash* e krijuar si rezultat i akumulimit në vite të shtesave

dhe pakësimeve mbi shumën prej 1.900.000 lekësh e përfituar *cash* në vitin 2004, si rezultat i mbylljes së investimit në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, investim i deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003.

9. Në këtë qëndrim kam vlerësuar çështjen se si pasaktësia për shkak të mosdeklarimit në deklarimet periodike të subjektit të rivlerësimit, si gjendje në *cash*, e shumës së përfituar nga mbyllja e investimit në bono thesari, afekton analizën financiare të vitit 2014 e, për pasojë, gjithë diferencën negative të konstatuar nga Komisioni për periudhën financiare 2011-2014. Gjithashtu, kam mbajtur në konsideratë edhe faktin se nga hetimi administrativ i kryer në Komision, nuk rezultoi e provuar që me këtë veprim (mosdeklarimin në deklaratat e viteve 2004-2014 të disponimit në *cash* të së ardhurës nga mbyllja e investimit në bono thesari), subjekti i rivlerësimit të ketë pasur si qëllim të mbajë jashtë vëmendjes dhe kontrollit të organit kompetent (ILDKPKI-së) këto pasuri të luajtshme dhe veprimet lidhur me to, në formën e deklarimit të rremë.
10. Në vlerësimin e mësipërm, kam mbajtur në konsideratë, në mënyrë integrale e në harmoni me njëra-tjetrën, rrethanat si vijojnë.

10.1 Të ardhurat e përfituara nga mbyllja e investimit në bono thesari kanë qenë të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, pasi ligjshmëria e krijimit të tyre është verifikuar nga Komisioni<sup>68</sup>, i cili në vendim, në lidhje me këtë investim, nuk ka arritur në një vlerësim të kundërt, po ashtu të njëjtin vlerësim ka pasur edhe shumica në Kolegj.

10.2 Mosdeklarimi i shumës prej 1.900.000 lekësh si gjendje *cash* nga viti 2004 e në vijim, sipas shpjegimeve të dhëna në mënyrë persistente dhe konsekuente nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision dhe në ankim, ka ardhur pikërisht si pasojë e perceptimit të saj se, duke deklaruar likuiditetin bankar në bono thesari në gjendje prej 1.900.000 lekësh në vitin 2003, në kushtet kur këto likuiditete janë tërhequr dhe nuk përfaqësonin kursime të krijuara në vitin 2004, në fakt nuk kishin pësuar shtim apo pakësim në momentin e disponimit *cash*, por vetëm kishin ndryshuar vendin e ruajtjes së tyre, nga banka në banesë. Për më tepër kjo shumë është tërhequr në tetor të vitit 2004 dhe për periudhën në vijim, deri më 31.12.2004, nuk është provuar krijimi i një pasurie apo kryerja e shpenzimeve, fakt ky që do të vinte në dyshim ekzistencën e saj në janar të vitit 2005 dhe, për rrjedhojë, mbartjen e saj si gjendje *cash-i* në këtë vit dhe vitet pasardhëse.

10.3 Në vitet në vijim të vitit 2004, në çdo deklaratë pasurie të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar qartë shtesat dhe pakësimet e kursimeve në *cash*, në përputhje me detyrimin që buronte nga parashikimet e nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, duke i konsideruar ato si shtesa dhe pakësime mbi gjendjen *cash* të fundit të vitit 2004, prej 1.900.000 lekësh.

10.4 Nga viti 2004 i mbylljes së investimit në bono thesari deri në vitin 2011, kur subjekti ka filluar të deklarojë pakësimin e gjendjes *cash*, nuk evidentohet që shuma prej 1.900.000

---

<sup>68</sup> Shih paragrafin 37 të vendimit të Komisionit.

lekësh të jetë deklaruar krijimi i ndonjë pasurie, me burim të deklaruar shumën e sipërcituar të përfituar nga tërheqja në vitin 2004 të shumave të depozituara më parë në bono thesari.

**10.5** Deklarimi nga personi i lidhur, në cilësinë e zyrtarit deklarues pranë ILDKPKI-së, në deklaratën para fillimit të detyrës, e dorëzuar në datën 15.11.2013, të gjendjes së kursimeve në *cash* në shumën 1.600.000 lekë, vërteton se kjo shumë ka ekzistuar realisht e deklaruar pranë organit kompetent. Nga përlllogaritja e gjendjes së kursimeve në *cash*, sipas shtesave dhe pakësimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në vite duke marrë në konsideratë edhe tërheqjen në *cash* të bonove të thesarit në shumën 1.900.000 lekë në vitin 2004, rezulton se shuma e kursimeve në *cash* në vitin 2016 ishte në shumën 1.600.000 lekë sa ka deklaruar, korrektësisht, personi i lidhur, si pasuri e akumuluar në vite.

Deklaratës së interesave private para fillimit të detyrës e plotësuar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, Komisioni dhe shumica e trupit gjykues duhet t'i kishte dhënë vlerën provuese të një akti dokumentar, i cili merr peshë veçanërisht të shtuar në funksion të kontrollit të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, jo vetëm për shkak të parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, por edhe sepse është dorëzuar dukshëm në kohë, përpara fillimit procesit të rivlerësimit, duke sqaruar/korrigjuar pasaktësinë në mosdeklarimin e *cash*-it, në deklaratën e vitit 2004.

**10.6** E njëjta situatë paraqitet edhe në deklarimin periodik vjetor të vitit 2013 (dorëzuar në datë 26.03.2014), të kryer nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në cilësinë e zyrtarit deklarues pranë ILDKPKI-së, në të cilën janë deklaruar ndryshimet e interesave private për periudhën tetor 2013-dhjetor 2013. Në këtë deklaram, personi i lidhur ka deklaruar të njëjtën vlerë të kursimeve gjendje në *cash*, në shumën 1.600.000 lekë, çka do të thotë se kjo shumë nuk është përdorur, por është transferuar si e tillë në vitin 2014, vit në të cilin është deklaruar pakësimi i saj si nga subjekti i rivlerësimit edhe personi i lidhur, në deklaratat përkatëse të interesave.

**10.7** Në deklaratat vijuese të pasurisë deri në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, dorëzuar në janar të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar kursime në *cash*, në vijim të deklarimit të vitit 2014, në të cilin kanë pakësuar gjithë gjendjen e kursimeve në *cash*, duke provuar kështu vërtetësinë e deklarimit në vitin 2014.

**10.8** Në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, nga kontrolli dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni, pasuritë e subjektit të rivlerësimit kanë rezultuar të krijuara me burime të ligjshme dhe nuk ka kryer fshehje apo deklarim të rremë të saj.

Diferenca negative e analizës financiare 2011-2014, e konstatuar nga Komisioni, afektohet në masë të konsiderueshme, nga vlerësimi i gabuar i gjendjes së kursimeve të disponueshme në *cash* në vitin 2014.

**10.9** Gjithashtu, në këtë vlerësim, nuk mund të lë pa theksuar dhe faktin se nga autoritetet ndihmëse për kontrollin e kriterit të figurës nuk është raportuar asnjë dyshim apo indicie për përfshirje të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, të cilat mund të shërbenin për të lëkundur bindjen se subjekti i rivlerësimit, në kushtet kur nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në banesë të shumës prej 1.900.000 lekësh, të rrjedhur nga mbyllja e investimit në bono thesari në

vitin 2004, do ta kishte shpenzuar atë dhe, për pasojë, kursimet e deklaruara në vitin 2013 në shumën 1.600.000 lekë, do të buronin nga burime të paidentifikuara.

11. Pas analizimit të të gjitha rrethanave të faktit të cituara më sipër, të cilat qëndrojnë në harmoni dhe në pajtueshmëri të dukshme me njëra-tjetrën, në përputhje me kriterin e vendosur nga neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, kam arritur në konkluzionin se, nën frymën e një shqyrtimi objektiv të çështjes, deklarimi i subjektit të rivlerësimit se ka pakësuar kursimet në *cash* në vitin 2014 në shumën 1.600.000 lekë, është një deklaram bindës dhe i besueshëm.
12. Qëndrimi i mësipërm u orientua edhe nga jurisprudenca e Kolegjit<sup>69</sup> në raste të ngjashme kur janë verifikuar deklaramet e likuiditeteve, të rrjedhura nga burime të ligjshme të krijimit të pasurive, për të cilat subjektet e rivlerësimit nuk kanë deklaram disponimin e tyre *cash* në banesë në fund të vitit.
13. Për sa më lart, vlerësoj se kursimet në *cash* të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, prej 1.600.000 lekësh, buruar kryesisht nga mbyllja e investimit në bono thesari në vitin 2004, pranuar edhe nga Komisioni si shumë e krijuar nga burime të ligjshme nga subjekti dhe personi i lidhur, duhej të ishte konsideruar nga shumica e trupit gjykues si shumë e përdorur në vitin 2014. Konsiderimi i kësaj shume do ta kthente balancën e pamjaftueshmërisë në analizën financiare të vitit 2014, nga shifra negative prej (-)1.417.908 lekësh e konstatuar nga Komisioni dhe e konkluduar edhe nga Kolegji, në vlerën pozitive prej 138.734 lekësh.
14. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 2011-2014, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera, në vlerën totale prej 2.786.519 lekësh. Në verifikim të analizës financiare të kryer në Komision për subjektin e rivlerësimit, Kolegjit i rezultoi që pamjaftueshmëria financiare për periudhën 2011-2014 është në vlerën 2.734.009 lekë<sup>70</sup>. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, nëse në analizën financiare të Komisionit do të korrektohej rezultati i vitit 2014, pamjaftueshmëria e evidentuar nga Komisioni do të reduktohej në vlerën prej 1.368.611 lekësh, ndërsa ajo e evidentuar nga Kolegji në vlerën prej 1.316.101 lekësh.
15. Në vlerësimin dhe bindjen time, mungesa e burimeve të ligjshme në vlerën prej 1.316.101 lekësh, sidomos në kushtet kur është një mungesë e evidentuar që nuk justifikon kryerjen e shpenzimeve dhe jo krijimin e pasurive, nuk duhet konsideruar si një shumë që e vë subjektin në kushtet e mosarritjes së një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe as të një deklarimi të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, mbështetur dhe në jurisprudencën e krijuar të Kolegjit<sup>71</sup>.
16. Bazuar në sa më sipër, si dhe duke pasur në konsideratë konkluzionet në vendimin e Komisionit, për kontrollin e kriterit të figurës dhe atë të aftësive profesionale, çmova se subjekti

---

<sup>69</sup> Vendimi nr. 33/2021 (JR), datë 03.11.2021, paragrafi 44; vendimi nr. 37/2021 (JR), datë 24.11.2021, paragrafi 10.25; vendimi nr. 20/2022, datë 14.06.2022, paragrafi 14; vendimi nr. 29/2022 (JR), datë 21.07.2022, paragrafi 27.

<sup>70</sup> Për më shumë shiko vendimin nr. 9, datë 15.03.2023.

<sup>71</sup> Vendimet e Kolegjit nr. 18/2021; nr. 26/2021; nr. 17/2022; nr. 19/2022, etj.

i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 59, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, duke arritur në një nivel të besueshëm në vlerësimin e të tria kritereve.

17. Për të gjitha sa arsyetova më lart, kam votuar për ndryshimin e vendimit nr. 263, datë 17.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Nure Dreni.

**GJYQTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam për ndryshimin e vendimit nr. 263, datë 17.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Nure Dreni dhe në ndryshim nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit kam votuar kundër vendimit nr. 9, datë 15.03.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim Kolegji), që vendosi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit.
2. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk duhej të ishte ngarkuar me përgjegjësi disiplinore në kuptim të nenit 61, pika 3, bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016 dhe t’i jepej masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, ndër të tjera, lidhur me moskonsiderimin e vlerës prej 1.600.000 lekësh, si gjendje *cash* në banesë, pakësuar në vitin 2014, shumë e deklaruar si likuiditet në bono thesari në vitin 2003 në vlerën prej 1.960.000 lekësh, edhe pse nga tërheqja e tyre nga Banka e Shqipërisë dhe kalimi gjendje *cash* (shtesë *cash* në shtëpi), brenda një kohe shumë të shkurtër, nuk është pasqyruar si e tillë nga subjekti i rivlerësimit në deklarin e vitit 2004. Votën time kundër e bazoj në qëndrim të mëparshëm që kam mbajtur<sup>72</sup> lidhur me interpretimin që i kam bërë jurisprudencës së krijuar të Kolegjit sa i përket konsiderimit të *cash*-it, duke referuar si provë deklarin për shtesa apo pakësim të tij në deklaratat periodike vjetore, të paraqitura në ILDKPKI, të cilat, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mund të përdoren si provë nga organet e rivlerësimit.
3. Duke qenë në përgjithësi dakord me vendimin e shumicës lidhur me mungesën e burimeve në analizën financiare të viteve 2011 – 2014, sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për mënyrën e deklarin të shpenzimeve të jetesës, të shkollimit të vajzave të subjektit, të të ardhurave nga dietat e bashkëshortit të subjektit, e duke përjashtuar vetëm një element nga kjo analizë, që i referohet konsiderimit të deklarin *cash* prej 1.600.000 lekësh si të pakësuar në vitin 2014, element i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në analizën financiare të vitit 2014, duke e shndërruar atë në vit me një balancë pozitive dhe duke ulur pamjaftueshmërinë e konkluduar nga shumica nga vlera prej (-) 2.734.009 lekësh në një vlerë rreth (-) 1.134.009 lekë, shprehem për aplikimin e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit. Argumentet e mia për këtë qëndrim janë si më poshtë.
4. Komisioni, në vlerësimin e kriterit të pasurisë, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarin të pamjaftueshëm, si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara, për katër vite, e konkretisht, 2011-2014, duke rezultuar me një balancë totale negative në total prej (-) 2.786.519 lekësh. Në përfundim të rivlerësimit, me vendimin nr. 263, datë 17.06.2020, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Nure Dreni, pasi nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera, për vitet 2011 – 2014. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarin të pamjaftueshëm, në kuptim të pikave 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>72</sup> Vendimi nr. 41/2022 (JR), datë 31.10.2022, për subjektin e rivlerësimit E. Kaja, qëndrimi i pakicës.



5. Shumica e trupit gjykues të Kolegjit në këtë vendim, lidhur me kontrollin e vendimit të Komisionit, mbi bazën e shkaqeve të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, në përfundim, ka konkluduar në paragrafët 26 dhe 27 si më poshtë:

*“26. Në përfundim të arsytimit të mësipërm, pasi analizoi në detaj të gjithë shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, si dhe pasi shqyrtoi provat e administruara në këtë çështje, trupi gjykues i Kolegjit i gjen të bazuara konkluzionet e Komisionit. Bazuar në analizën e mësipërme faktike dhe ligjore, rezulton se balanca negative e përllogaritur nga Komisioni për shpenzimet dhe investimet e kryera për periudhën 2011-2014, edhe duke pranuar disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit për zëra të caktuar, mbetet thuajse e njëjtë me atë të gjetur nga Komisioni. Konkretisht, duke pranuar disa nga pretendimet e subjektit, balanca për këto katër vite, në analizën e kryer nga Kolegji ulet në nivel të papërfillshëm, nga (-) 2.786.521 lekë në (-) 2.734.009 lekë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33 pika 5 germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*

*27. Në përmbledhje dhe për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 263, datë 17.06.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi”.*

6. Referuar akteve në fashikull të deklarimeve periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit për gjendjen e *cash*-it, si dhe bonot e thesarit, rezulton se:

- Për vitin **2003** - deklaruar: “Bono thesari në BSH 1.9 milion lekë, si dhe 6.500 euro në shtëpi”.
- Për vitin **2004** - deklaruar: “Gjendje cash 1.000.000 lekë”.
- Për vitin **2005** - deklaruar: “Gjendje cash, shuma 200.000 lekë”.
- Për vitin **2006** - deklaruar: (i) “Pakësuar nga gjendja e deklaruar në vitet e mëparshme në cash, vendosje në bono thesari, llogari në BSH llog. {\*\*\*}, shuma prej 420.000 lekësh; si dhe (ii) shtesa vjetore në lekë nga të ardhurat, paga, interesat, etj., shuma prej 1.200.000 lekësh”.
- Për vitin **2007** - deklaruar: (i) “Pakësuar nga gjendja e raportuar në euro për vitin 2006, (sipas pikës 1, formular 3 të deklaruar në vitin 2007) 10.480 euro; (ii) shtesa në bono thesari nga pakësimi i eurove, sipas pikës 1, në BSH nr. llog. {\*\*\*}, shuma prej 1.300.000 lekësh; si dhe (iii) shtesa vjetore në lekë nga të ardhurat, paga, interesat, etj. Shuma prej 1.000.000 lekësh”.
- Për vitin **2008** - deklaruar: (i) “Pakësuar nga gjendja e raportuar në lekë për vitin 2007 (sipas pikës 1, formular 3 të deklaruar në vitin 2008), shuma prej 300.000 lekësh; (ii) shtesa në bono thesari nga pakësimi i gjendjes në lekë prej 300.000 lekësh; si dhe (iii) shtesa vjetore në lekë nga pagat, interesat bankare, eurot (shkëmbim) etj., shuma prej 600.000 lekësh”.

- Për vitin **2009** - deklaruar: “Shtesë vjetore në lekë nga pagat, interesat, shuma prej 200.000 lekësh”.
- Për vitin **2010** - deklaruar: “Pakësim dhe mbyllje të llogarisë në bono thesari në BSH, deklaruar në deklaratat e mëparshme në vite dhe kalim në llogari rrjedhëse në BKT me nr. {\*\*\*} (më vonë transaksion në llogarinë e S. D. me nr. {\*\*\*} 2.020.000 lekë”.
- Për vitin **2011** - deklaruar: “Nuk kam ndryshime”.
- Për vitin **2012** - deklaruar: “Pakësim i gjendjes cash deklaruar në deklaratat e mëparshme ndër vite shuma prej 800.00 lekësh”.
- Për vitin **2013** - deklaruar: “Pakësim në gjendjen cash deklaruar në deklaratat e mëparshme ndër vite, shuma prej 900.000 lekësh”.
- Për vitin **2014** - deklaruar: “Pakësim në gjendjen cash deklaruar në deklaratat e mëparshme ndër vite, shuma prej 1.600.000 lekësh”.

7. Gjithashtu, për gjendjen *cash* dhe bonot e thesarit rezultojnë që të ketë bërë deklarime edhe personi i lidhur/bashkëshorti në deklaratat periodike, të cilat janë komplementare me deklaratimet që ka bërë subjekti i rivlerësimit.

- Për vitin **2006** - (i) pakësuar depozita në euro në Bankën Amerikane dhe shtuar cash në shtëpi 10.480 euro; si dhe (ii) pakësuar nga gjendja e deklaruar në vitet e mëparshme dhe vendosje në bono thesari, llogari në BKT nr. {\*\*\*}, shuma prej 2.000.000 lekësh.
- Për vitin **2007** - pakësuar nga gjendja e deklaruar nga vitet e mëparshme në cash, vendosje në depozitë BA nr. llog. {\*\*\*}, shuma prej 5.000 eurosh.
- Për vitin **2008** - shtesa në bono thesari nga pakësimi i eurove (sipas pikës 1 – 5.000 euro), shuma prej 500.000 lekësh.
- Për vitin **2009** - shtesa në bono thesari nga të ardhurat nga puna këtë vit, shuma prej 500.000 lekësh.
- Për vitin **2010** - (i) pakësime në bono thesari në BKT, deklaruar në deklaratimet e mëparshme, shuma prej 3.000.000 lekësh; si dhe (ii) shtesë në depozitë bankare dhe llogari rrjedhëse në BKT nga pakësimi i bonove të thesarit të bashkëshortes Nure Dreni dhe nga të ardhurat e mia, shuma prej 1.980.000 lekësh.
- Për vitin **2011** - nuk ka deklarim.
- Për vitin **2012** - nuk ka deklarim për *cash*.
- Për vitin **2013** - bashkëshorti ka marrë statusin e subjektit deklarues, sipas ligjit nr. 9049/2003, për shkak të fillimit të një detyre të re dhe në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës (DPFD), ka deklaruar, ndër të tjera, *cash* në shumën 1.600.000 lekë.

8. Lidhur me burimin e shumës së deklaruar nga bashkëshorti i subjektit në DPFD-në e vitit 2013, shumica në vendim<sup>73</sup> është shprehur se burimi i krijimit të kësaj shume mungon. Konstatohet se kjo gjetje e shumicës nuk është e bazuar në fakte, pasi, po në të njëjtën deklaratë (DPFD), në faqen 4, në rreshtin e tretë, fjalia e dytë, personi i lidhur, ka deklaruar: (i) gjendje *cash* 1.600.000 lekë (rreshti i parë); (ii) depozitën në euro pranë BKT-së Tiranë, nr. {\*\*\*}, 5.228 euro (rreshti i dytë); si dhe (iii) depozitën në llogarinë e BKT-së Tiranë nr. {\*\*\*}, 3.962.459 lekë (rreshti i tretë), në mënyrë të përgjithshme ka bërë deklarimin e burimit: “Për të gjitha pasuritë të

<sup>73</sup> Paragrafi 25.3, shkronja “e” e këtij vendimi.

*luajtshme dhe të paluajtshme këto janë burimet nga të ardhurat, pagat, interesat, aktivitet privat, nga shitja e pasurisë së paluajtshme përshkruar më sipër”, edhe pse nuk ka përmendur në mënyrë eksplicite burimin nga bonot e thesarit, të vitit 2003.*

9. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit të datës 27.09.2019, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shuma e [...] *tërhequr në fund të muajit tetor të vitit 2004 [...] (1960000 lekë) është mbajtur [...] cash në banesë [...] pakësuar në vitet e mëvonshme sipas deklaratave periodike të pasurisë deri në vitin 2015 [...].*
10. Gjithashtu, në pyetësorin e datës 03.10.2019, subjekti i rivlerësimit, duke u qëndruar shpjegimeve të mëparshme të dhëna në mënyrë shumë të detajuar lidhur me deklarin e gjendjes *cash*, me burim bonot e thesarit, është shprehur, ndër të tjera, se: *“Po ju bëj me dije edhe njëherë se në vitin 2003, është deklaruar në emër të personit të lidhur bashkëshortit S. D., gjendje në fund vitit në llogari bono thesari në Bankën e Shqipërisë shuma afërsisht 1.960.000 lekë (1.260.000+700.000), çka tregon se një pjesë e shumës së tërhequr nga investimi fillestar (2002-2003) është investuar përsëri në bono thesari. Kjo shumë, si likuiditet i investuar në bono thesari, është tërhequr në fund të muajit tetor të vitit 2004 dhe është mbyllur llogaria në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë. Shuma më lartë (1.960.000 lekë) është mbajtur pas muajit tetor të vitit 2004 cash në banesë, e cila është pakësuar në vitet e mëvonshme, sipas deklaratave periodike të pasurisë deri në vitin 2015”.*
11. Të njëjtin qëndrim konstant ka mbajtur subjekti i rivlerësimit edhe në seancën dëgjimore të datës 03.03.2020, ku krahas pohimeve të mësipërme shprehet se harresa/gabimi/pasaktësia në mosdeklarimin e shumës *cash* prej 1.960.000 lekësh në deklaratën periodike të vitit 2003 dhe 2004, lidhet me plotësimin e deklaratave të para të deklarimit të pasurive, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9049/2003, ku edhe paqartësitë e mangësitë në plotësimin e tyre nuk janë të qëllimshme.
12. Nga një panoramë e përgjithshme e krijuar nga deklarinimet e mësipërme më krijohet bindja se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur janë përpjekur që në përputhje me parashikimet ligjore të deklarojnë me saktësi, korrektësi dhe përgjegjësi pasurinë likuiditet që i korrespondon gjendjes së *cash*-it si kursime në vite, përfshirë këtu edhe bonot e thesarit, duke referuar në shtesa dhe pakësime të tyre, sipas viteve respektive. Gjithashtu, konstatohet qartë se referuar dy paragrafëve të mësipërm (6 dhe 7), rezulton se subjekti i rivlerësimit, lidhur me gjendjen *cash* në lekë që ka mbajtur në banesë, pakësimet ka filluar që t’i deklarojë në deklaratat periodike të viteve 2012, 2013 dhe 2014.
13. Konstatoj se subjekti i rivlerësimit, me deklarimin e gjendjes *cash*, referuar kursimeve nga të ardhurat e viteve 2003 dhe 2004, ka krijuar një keqkuptim dhe është konfunduar duke mos e konceptuar edhe ndryshimin e statusit të shumës prej 1.960.000 lekësh nga bono thesari në gjendje *cash* në banesë e për ta deklaruar si të tillë. Por ky keqkuptim, në vlerësimin tim, nuk do të thotë që kjo shumë nuk ka ekzistuar. Për sa kohë është deklaruar tërheqja e bonove të thesarit në tetor të vitit 2004, shoqëruar me mbylljen e llogarisë në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, deklarim që është pranuar dhe nga Komisioni, edhe pse subjekti nuk e ka shprehur këtë veprim si shtesë të gjendjes *cash* prej 1.960.000 lekësh në deklaratën e vitit 2003, çmoj se rrethanat janë të tilla që kjo shumë duhej konsideruar e pakësuar në vitet në vazhdim, ashtu si

është deklaruar në vitin 2014. Këtë arsyetim, sikurse e kam shprehur në qëndrimin tim të mëparshëm<sup>74</sup>, në analizën rast pas rasti e bazoj në:

- Deklarimin në deklaratën e vitit 2003 të investimit në bono thesari në Bankën e Shqipërisë prej 1.9 milion lekësh, si një shumë nga të ardhura me burim të ligjshëm.
- Ekzistencën e llogarisë së bonove të thesarit në Bankën e Shqipërisë deri në tetor 2004 në shumën prej 1.960.000 lekësh. Pra, rezulton se subjekti dhe personi i lidhur e kanë poseduar këtë shumë të pretenduar, konstatuar nga Komisioni dhe nga Kolegji.
- Tërheqjen e shumës dhe mbylljen e llogarisë në Bankën e Shqipërisë në tetor 2004.
- Qenien e shumës prej 1.960.000 lekësh, si gjendje *cash* në shtëpi, edhe pse e padeklaruar në deklaratën periodike, por e nënkuptuar.
- Mosrezultimin e depozitimit të kësaj shume në ndonjë llogari bankare nga subjekti apo personi i lidhur.
- Mos kryerjen e shpenzimeve/investimeve nga ana e subjektit në vitet në vijim që vijnë si rezultat i përdorimit të kësaj shume *cash*.
- Deklarimin nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit të gjendjes *cash* prej 1.600.000 lekësh në DPFDF në vitin 2013, si një gjurmë tjetër, afër vitit 2014 dhe larg fillimit të procesit të rivlerësimit, e cila, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mund të konsiderohet si provë.
- Pakësimin në gjendjen *cash* të shumës prej 900.000 lekësh, deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2013, e cila nuk do të ishte e mundur që të ndodhte, nëse nuk do të ekzistonte gjendja *cash* prej 1.600.000 lekësh.
- Sjelljen e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, që kanë deklaruar në mënyrë korrekte gjendjen *cash* në vite, përfshirë shtesat dhe pakësimet.

14. Referuar argumenteve të mësipërme, vlerësoj se shuma *cash* e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit prej 1.600.000 lekësh, si gjendje e deklaruar në vitin 2013 në DPFDF të personit të

---

<sup>74</sup> Vendim nr. 41/2022 (JR), datë 31.10.2022, i subjektit të rivlerësimit E. Kaja, qëndrimi i pakicës, paragrafët e mëposhtëm:

“8.3.5. Edhe pse tashmë Kolegji ka një qëndrim të konsoliduar për pranimin e ekzistencës së likuiditeteve *cash*, ku si provë e domosdoshme konsiderohet deklarata periodike vjetore, unë si anëtare e Kolegjit i qëndroj mendimit që vlerësimi dhe interpretimi duhet bërë rast pas rasti edhe për mundësinë e krijimit të një *cash*-i të ligjshëm, por të padeklaruar nga shkaqe që kanë ose jo një peshë të caktuar në analizën financiare si dhe në historikun e detyrimit për deklarim të pasurive dhe interesave financiare të subjekteve të rivlerësimit. Konkretisht, për subjektin e rivlerësimit Eda Kaja, më rezulton se:

8.3.6. Në rastin konkret, çmoj se pavarësisht mosdeklarimit të gjendjes *cash*, ka rezultuar se për çdo pasuri të krijuar nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij, burimi financiar ka qenë i ligjshëm, i rrjedhur nga të ardhurat nga puna, biznesi apo veprime të tjera juridike të ligjshme. Në këto rrethana nuk mund të bëhet zero kjo vlerë vetëm se nuk është deklaruar në deklaratat vjetore, sikurse argumenton shumica, edhe pse rezulton e provuar mundësia e krijimit të saj nga Komisioni dhe Kolegji.

8.3.7. Referuar arsyetimit të shumicës për gjendjen *cash* dhe deklarimin në deklaratat periodike vjetore si mënyrë e vetme e provimit të ekzistencës së tij, ndaj mendim të kundërt, pasi jo domosdoshmërisht mosdeklarimi i *cash*-it provon mos ekzistencën e tij. Duke analizuar gjendjen financiare të subjektit ndër vite rezultojnë shuma të ardhurash të pasqepënuara gjatë vitit të krijimit. Pavarësisht mosdeklarimit të tyre, provohet se ato kanë ekzistuar dhe janë të ardhura të krijuara me burime të ligjshme e në këto rrethana duhet të ishin marrë parasysh nga shumica në analizën financiare të subjektit.

8.3.8. Procesi i rivlerësimit të subjektit sipas Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 është kompleks dhe përfshin në analizë rrethana e fakte të shumta që lidhen me të, e për pasojë edhe në rastin e *cash*-it nuk mund të mbetet vetëm një vlerësim mekanik dhe i ngurtë i deklaratave vjetore të pasurisë, të cilat përbëjnë vetëm një provë në këtë proces pa asnjë vlerë të shtuar në krahasim me provat e tjera të administruara”.

lidhur, duke shërbyer si një gjurmë e *cash*-it të krijuar nga tërheqja e bonove të thesarit në vitin 2004, edhe pse e pashprehur literalisht, por e nënkuptuar, si dhe larg procesit të rivlerësimit, duhej të ishte konsideruar nga shumica e trupit gjykues si shumë e pakësuar në vitin 2014. Konsiderimi i kësaj shume do ta reduktonte vlerën e pamjaftueshmërisë së konstatuar nga shumica e trupit gjykues nga (-) 2.734.009 lekë në një vlerë rreth (-) 1.134.009 lekë, që do të sillte për aplikim parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit.

15. Mosdeklarimi i gjendjes *cash* si shtesë në vitin 2004, me burim nga tërheqja e bonove të thesarit nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të atij viti, nuk e ngarkon atë me përgjegjësi të tillë sa të sjellë shkarkimin nga detyra. Baza e vlerësimit të subjektit, sipas nenit 30 e vijues të ligjit, është deklarata e pasurisë *vetting* e dorëzuar me nisjen e procesit të rivlerësimit. Duke analizuar këtë deklaratë, rezulton se subjekti ka kryer deklaram të saktë, nuk ka mungesë burimesh financiare për krijimin e pasurisë dhe nuk ka kryer fshehje apo deklaram të rremë të saj.
16. Vlerësoj se shumica e trupit gjykues, në vlerësimin tërësor, bazuar në nenin 4, pikat 2 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, duhet të kishte aplikuar parimet e objektivitetit dhe të proporcionalitetit për kriterin e pasurisë, mbështetur në jurisprudencën e krijuar të Kolegjit, duke qenë se subjekti i rivlerësimit është konfirmuar nga Komisioni, për sa i përket kriterit të figurës dhe atij të vlerësimit të aftësive profesionale.
17. Në përfundim të arsytimit të mësipërm, duke qenë se shkeljet e konstatuara vetëm për kriterin e pasurisë nuk kanë peshën për aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, konkludoj se vendimi nr. 263, datë 17.06.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit Nure Dreni, duhej të ndryshohej dhe subjekti duhej të kthehej në detyrë.

**Gjyqtare**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*